



Save the Children

UDHËZUESI

**MBI PRAKTIKAT E MIRA TË ARSIMIT
GJITHËPËRFSHIRËSE NË SHKOLLA**



Save the Children

UDHËZUESI

MBI PRAKTIKAT E MIRA TË ARSIMIT
GJITHËPËRFSHIRËSE NË SHKOLLA

Udhëzuesi mbi praktikat e mira të arsimit gjithëpërfshirëse në shkolla

Autoret:

Erjona Pllashniku
Valbona Makovci

Publikuar nga Save the Children Kosova

Rr. Filip Shiroka 27, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 551 691
Email: scik@savethechildren.org

Të drejtat e publikimit © Save the Children Kosova, 2021.

Lejohet fotokopjimi i këtij dokumenti për përdorim me qëllim për të promovuar zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës. Të gjitha të drejtat e tjera të rezervuara.

Dizajni i ballinës dhe radhitja kompjuterike nga Gojart Sejdiu, Pi Communication.
Printuar dhe lidhur nga Pi Communication.

PËRMBAJTJA

QËLLIMI DHE RËNDËSIA E UDHËZUESIT	5
HYRJE	7
METODOLOGJIA.....	11
PLANI INDIVIDUAL I ARSIMIT	13
EKIPI VLERËSUES KOMUNAL.....	19
INDEKSI PËR GJITHËPËRFSHIRJE.....	27
PËRMIRËSIMI I PRAKTIKAVE PEDAGOGJIKE NË OFRIMIN E ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS.....	33
MËSIMDHËNËSIT MBËSHTETËS.....	43
IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE JASHTË SHKOLLAVE & FUSHATAT SENSIBILIZUESE PËR REGJISTRIM TË NXËNËSVE	49
NDËRLIDHJET MES SHKOLLËS, DKA-ve, MASHTI-t, OSHC-ve DHE KOMUNITETIT	53
SI TË BËHEMI SHKOLLË PËR TË GJITHË?	57
REFERENCAT	59

SHKURTESAT

PIA	Plani Individual i Arsimit
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
MASHTI	Minsitria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
DPAP	Departamenti për politika për arsimin parauniversitar
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
UA	Udhëzim Administrativ
SHFMU	Shkolla fillore dhe e mesme e ulët
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
QB	Qendra Burimore
HANDIKOS	Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës
KKK	Korniza e Kurrikuli e Kosovës
QPS	Qendra për Punës Sociale
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare

QËLLIMI DHE RËNDËSIA E UDHËZUESIT

Ky dokument ka për qëllim të shërbejë si udhëzues me praktikatat e mira të arsimit gjithëpërfshirës nga shkollat, për shkollat. Udhëzuesi paraqet një ndihmes shtesë për shkollat të cilat dëshirojnë të bëhen shkolla gjithëpërfshirëse, duke iu ofruar përshkrime të detajuara të secilit element të gjithëpërfshirjes në arsim, duke ofruar edhe tre-gjime rastesh. Udhëzuesi ka rëndësi të veçantë për ngritjen e cilësisë së përgjithshme të arsimit në Republikën e Kosovës, duke u fokusuar në përmirësimin dhe shtrirjen më të gjerë të shkollave gjithëpërfshirëse. Udhëzuesi i shërben nevojave të zgjerimit të modeleve të arsimit gjithëpërfshirës si dhe dokumentimit të punës së bërë deri më sot në këtë drejtim. Përmes këtij udhëzuesi, shkollat do të kenë mundësinë që hap pas hapi të zbatojnë praktika dhe metodologji të cilat janë provuar të suksesshme që të realizojnë të drejtën në arsim për të gjithë.

Ky publikim i praktikave të mira të arsimit gjithëpërfshirës në shkolla përveç që mund të përdoret për të ngritur vetëdijen në shkollat e reja që janë cak, gjithashtu do të përdoret si burim dhe pikë fillestare për diskutim brenda shkollave, Drejtorive Komunale të Arsimit, si dhe insitucioneve dhe akteveve tjerë që merren me fushën e arsimit gjithëpërfshirës.

Udhëzuesi përmban informata për të gjithë ata që dëshirojnë të dijnë më shumë për arsimin gjithëpërfshirës si dhe në veçanti iu dedikohet agjentëve kryesor të zbatimit të tij, e që janë drejtoritë e shkollave, mësimmhënësit, prindërit dhe vet fëmijët e shkollave gjithëpërfshirëse dhe atyre që synojnë të bëhen shkolla gjithëpërfshirëse në të ardhmen. Dokumenti mbështetet në dokumentet që janë në dispozicion, përfshi kuadrin ligjor, udhëzimet administrative, strategjitë, dhe dokumente tjera relevante që lidhen me arsimin në përgjithësi, dhe specifikisht me arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë.

HYRJE

Arsimi si e drejtë themelore e njeriut është përcaktuar në shumë deklarata ndërkombëtare që nga viti 1948 kur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e më fuqishëm në Konventën për të drejtat e fëmijës, sigurohet arsimi për të gjithë fëmijët, sipas aftësive të secilit. Arsimi gjithëpërfshirës shpesh keqkuptohet si koncept i cili aplikohet vetëm tek fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe ky fakt pikërisht na vendos pengesa në arritjen e arsimit gjithëpërfshirës.

Save the Children e përkufizon arsimin gjithëpërfshirës si *“arsim që iu mundëson të gjithë fëmijëve të mësojnë së bashku me mbështetje për nevojat e tyre individuale”*. Arsimi gjithëpërfshirës është një dimension i arsimit cilësor bazuar në të drejtat që thekson barazi në qasje dhe pjesëmarrje, dhe i përgjigjet pozitivisht nevojave individuale për nxënie dhe kompetencave të të gjithë fëmijëve. Arsimi gjithëpërfshirës ka në qendër fëmijën dhe vendos përgjegjësinë e adaptimit të sistemit arsimor në bazë të nevojave të fëmijës. Së bashku me sektorë të tjerë dhe me komunitete më të gjera, arsimi gjithëpërfshirës funksionon në mënyrë aktive për t'i siguruar çdo fëmije, pavarësisht gjinisë, gjuhës, aftësisë, fesë, kombësisë ose karakteristikave të tjera, mbështetje për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote, të mësojë së bashku me shokët dhe shoqet e tij/saj, si dhe të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë (Save the Children stands for inclusive education, 2014)¹.

Pse na duhet arsimi gjithëpërfshirës?

Arsimi gjithëpërfshirës cilësohet të jetë mjet i fuqishëm që krijon shanse të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht nevojave të tyre specifike. Përmes arsimit gjithëpërfshirës shmanget qasja diskriminuese ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vihen në pah vlerat personale të secilit nxënës, si dhe stimulon komunitetin për të bashkëvepruar në të mirë të të gjithëve. Kjo mënyrë e arsimit iu lejon fëmijëve të njohin më shumë veten, të pranojnë dhe të kuptojnë më shumë nevojat e njëri-tjetrit.

1 Inclusive education: What, Why, and How, Save the Children, 2016

Statistika për arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë

Sipas raportit Vlerësimi i Realizimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021², të dhënat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në sistemin e arsimit vazhdon të jetë sfidë. Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit për vitin shkollor 2020/2021 tregon se 3,939 fëmijë me aftësi të kufizuara janë të përfshirë në klasa të rregullta, si dhe 307 fëmijë vijnë në mësimin në qendra burimore³. Në këtë publikim thuhet se saktësia e këtyre të dhënave është komplekse për faktin se akoma nuk janë vlerësuar të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara nga Ekipet Vlerësuese Komunale.

Politikat dhe strategjitë

Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në promovimin e rëndësisë së arsimit gjithëpërfshirës si dhe përfshirjen e tij në politika e strategji të ndryshme në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011), siguron gjithëpërfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në mënyre specifike nenet: 40, 41, 43 dhe 44 rregullojnë arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në kuadër të kësaj, janë hartuar 7 Udhëzime Administrative të cilat përcaktojnë procedurat, instrumentet dhe rregullojnë çështjet specifike të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Edhe Korniza e Kurrikulit të Kosovës (KKK, 2010) ka gjithëpërfshirjen si parim bazë. Plani Strategjik i Arsim në Kosovë (PSAK) 2022-2026, gjithëpërfshirjen e ka si parim bazë për tërë sistemin e arsimit.

Gjithashtu, në kuadër të përmirësimit dhe avancimit të infrastruktures ligjore është rishikuar Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, i cili ndihmon komunat për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat pedagogjike të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç (2011), është një tjetër dokument që siguron qasje gjithëpërfshirëse në edukimin e hershëm ku në qendër është fëmija dhe arritjet e tij në periudha të caktuara të moshës dhe në fusha të ndryshme zhvillimi.

Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë, dokument që mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, paraqet qasje gjithëpërfshirëse që ndërlihd aspektet e reformës në arsim dhe që ka fëmijën në qendër në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe zbatohen në shkollë. Rruga për arritjen e arsimit

2 Vlerësimi i Realizimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017 - 2021: Arritje e Pamjaftueshme, KEC, 2021

3 Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/21, MASHT-ASK, 2021.

gjithëpërfshirës në shkollat tona është e shtruar mirë në aspektin legjislativ, mirëpo duhet vazhduar puna që të gjitha këto politika dhe strategji të gjejnë zbatim më të gjërë në praktikë.

Legjislacioni dhe strategjitë të cilat mbështesin dhe rregullojnë arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë janë:

- Ligji nr.04/L-032 mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës - Gjithëpërfshirja si koncept e përshkon tërë ligjin i cili është i bazuar në Deklaratën e Salamankës mbi gjithëpërfshirjen dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Nga ky ligj kanë dalur këto udhëzime administrative:
 - UA nr. 16/2017 Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
 - Normativ nr. 05/2021 mbi kuadrin profesional në arsimin e përgjithshëm
 - UA 12/2012 dhe 26/2012 janë të shfuqizuara dhe të përfshira e të plotësuara më vonë me UA 6/2015
 - UA 18/2013 Përdorimi i planit individual të arsimit;
 - UA 22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës;
 - UA 02/2018 Qendrat burimore;
 - UA 24/2013 Shëndrimi i klasave të bashkëngjitura në dhoma burimore.

Kornizat:

- Korniza e Kurrikulit të Kosovës (KKK), 2010 në harmonizim me Qëllimet Zhvillimore të Mileniumit dhe Arsimin për të Gjithë.
- Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjec, 2011
- Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë, 2012
- Plani Strategjik i Arsimin në Kosovë (PSAK) 2022–2026

Qendrat Burimore (shëndrrimi i shkollave speciale në qendra burimore)

Qendrat Burimore në Kosovë funksionojnë sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018. Qendrat Burimore janë një sistem i ri i ofrimit të arimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Qendrat Burimore janë krijuar nga shëndrrimi i shkollave speciale të cilat kanë ekzistuar më parë. Qendrat Burimore janë institucione arsimore që përmbajnë dy njësi: njësia e shkollës që organizon mësimdhënien për fëmijë me aftësi të kufizuara, dedikuar për llojet e ndryshme të dëmtimeve të renda dhe të shumfishta; dhe njësia e shërbimeve të mbështetjes e cila mbështet shkollat e rregullta që përfshijnë fëmijë me aftësi të kufizuara⁴.

Në Kosovë dikur kanë ekzistuar 7 shkolla speciale, 5 prej të cilave janë transformuar në Qendra Burimore:

1. Qendra Burimore për mësim dhe këshillim për fëmijë me dëmtime intelektuale “Përparimi” në Prishtinë;
2. Qendra Burimore për mësim dhe këshillim për fëmijë me dëmtime në të dëgjuar “Lef Nosi” në Prizren;
3. Qendra Burimore për mësim dhe këshillim për fëmijë me dëmtime intelektuale “Nënë Terezë” në Mitrovicë;
4. Qendra Burimore për mësim dhe këshillim për fëmijë me dëmtime intelektuale “Nënë Terezë” në Prizren; dhe
5. Qendra Burimore për mësim dhe këshillim për fëmijë me dëmtime në të parë “Xheladin Deda” në Pejë.

Ekzistojnë ende edhe dy shkolla speciale: ajo e Shtimes dhe e Mitrovicës së veriut ku vijojnë mësimin fëmijët serbë, por nuk është e integruar në sistemin arsimor të MASHTI-t dhe nuk kemi pasur qasje në to.

Qendrat Burimore luajnë një rol të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të shkollave të rregullta përmes ofrimit të shërbimeve profesionale nga Mësimdhënësit Udhëtues dhe përmes programeve të trajnimeve. Në Qendrat Burimore vijojnë mësimin fëmijët me aftësi të kufizuara të shumfishta.

4 Mbështetja e qendrave burimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta

METODOLOGJIA

Udhëzuesi për praktikat e mira të arsimit gjithëpërfshirës në shkolla është hartuar fillimisht duke shqyrtuar literaturën në dispozicion, si: ligje, udhëzime administrative, strategji dhe dokumente tjera relevante. Në këtë mënyrë është arritur të përshkruhet kuadri legjislativ ekzistues mbi arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë. Gjithashtu literatura ka shërbyer për të përshkruar të gjitha elementet e arsimit gjithëpërfshirës, duke iu ofruar lexuesve informata të shkurta dhe të sakta.


Puna në terren ka zënë vendin kryesor në hartimin e këtij udhëzuesi, përmes të cilave janë realizuar intervista me fëmijë / nxënës, prindër, Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) partnere, mësimdhënës, administratorë të shkollave të përfshira në programin e Save the Children Kosova, zyrtarë komunal dhe ata të MASHTI-t. Pjesë e marrjes së informatave nga terreni kanë qenë edhe fokus grupet me mësimdhënës, fëmijë e prindër në shtatë komuna, duke përfshirë këtu Prishtinën, Pejën, Gjakovën, Ferizajn, Prizrenin, Gjilanin dhe Mitrovicën. Nga të gjitha këto intervista dhe fokus grupe kanë dalur tregimet e rasteve.

Gjatë këtyre intervistave, rëndësi e veçantë i është kushtuar diferencimit të pyetësorëve dhe qasjes ndaj të intervistuarve përkitazi me karakteristikat e secilit grup.



PLANI INDIVIDUAL I ARSIMIT

“Plani Individual i Arsimit (PIA) është dokument zyrtar pedagogjik, i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues komunal apo edhe ekipi në nivel institucioni ka marrë vendim për arsim me nevoja të veçanta arsimore. PIA shërben për planifikimin sistematik të nxënies, mësimdhënies, për mbështetjen dhe ndjekjen e përparimit individual të fëmijës. PIA duhet të zhvillohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë shkollën, prindërit, fëmijët (kur është e përshtatshme) dhe personelin tjetër përkatës. PIA është një dokument i besueshëm (konfidencial) dhe informatat për të mund t’u jepen të tjerëve vetëm me lejen e prindërve. Ai i referohet përshtatjes së kurrikulës dhe fokusohet në nevojat me prioritet të nxënësit.” - Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe udhëzuesi për hartimin e planit individual të arsimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, 2017.



©Valbona Makovci

KUADRI LEGJISLATIV

MASHTI, në vitin 2017 ka hartuar udhëzuesin dhe formularin për hartimin e Planit Individual të Arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

HAP PAS HAPI

➤ Trajnimi për PIA

Programi i trajnimit për PIA përfshinë 4 ditë trajnimit me nga 8 orë, që do të thotë që çdo pjesëmarrës do të ketë 32 orë trajnim direkt. Pjesë e trajnimit janë edhe 8 orë tjera punë praktike që nënkupton se çdo pjesëmarrës deri në fund të programit të trajnimit përfiton 40 orë trajnimit gjithsej.

➤ Bashkëpunimi me Ekipin Vlerësues, prindërit, profesionistët, DKA-në

PIA hartohet për ata fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët paraprakisht janë vlerësuar nga Ekipi Vlerësues Komunal dhe është konstatuar që ka nevojë për mbështetje arsimore përmes planifikimit të PIA-s. Më pas, në bashkëpunim të ngushtë në mes të mësimdhënësit, drejtorit, prindit dhe në raste të caktuara edhe fëmijës, fillon hartimi i PIA-s, për të cilin mbanë përgjegjësi zakonisht mësimdhënësi. Hartimi i PIA-s ndodh pas disa takimeve të mbajtura nga grupi i lartëshënuar dhe duke marrur parasysh të gjitha perspektivat, caktohen objektivat e të nxëniet për fëmijën, për një kohë të caktuar.

Rëndësia e bashkëpunimit me Ekipin Vlerësues Komunal ndihmon në identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës por edhe në përcaktimin e shërbimeve që i

nevojiten fëmijes, përfshirë ketu edhe PIA-n. Ekipi Vlerësues mblidhet sipas kërkesave që adresohen nga shkollat. Është më se i rëndësishëm edhe roli i prindit / kujdestarit ligjor në hartimin dhe zbatimin e PIA-s, pasi që objektivat e caktuara duhet të përcillen dhe të zbatohen në bashkëpunim me prindërit / kujdestarët ligjor, sidomos kur kemi të bëjmë me aftësi dhe sjellje që duhet të përforcohen edhe në familje. Çdo ndryshim në PIA bëhet me njoftimin dhe pjesëmarrjen e prindit / kujdestarit ligjor.

➤ Realizimi

Për realizimin e suksesshëm të PIA-s, mësimdhënësit duhet të familjarizohen me udhëzuesin i cili jep informata për hartimin dhe zbatimin e PIA-s. Natyrisht është me shumë interes ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për PIA meqë vazhdon të kenë probleme në këtë drejtim. Rol të rëndësishëm në realizim luajnë materialet didaktike që përdoren në klasë me fëmijët për arritjen e objektivave. PIA duhet të rishikohet dy herë në vit në varesi të nevojave të nxënësit apo edhe në situata tranzicioni, p.sh kur ndërrohet shkolla, niveli, klasa apo komuna. Rishqyrtimin e bën ekipi përkatës, ku në varësi të rezultateve të prezantuara mund të rishikohen edhe objektivat e vëna dhe të riformulohen pritshmëritë.

➤ Rëndësia e PIA-s për tranzicionin / kalimin e fëmijëve

Në rastet kur fëmija kalon prej njërit në tjetrin institucion, prej një niveli të shkollimit në nivel më të lartë, prej Qendrës Burimore në shkollë të rregullt dhe anasjelltas, prej klasës së bashkëngjitur në klasë të rregullt dhe anasjelltas, PIA luan rol më se të rëndësishëm për një kalim efikas dhe sigurim të mbështetjes së vazhdueshme. Të gjitha informatat në lidhje me fëmijën duhet të barten nga shkolla e mëparshme në atë pranuese, gjithëmonë me lejen e prindit / kujdestarit ligjor. Në këtë PIA përfshihen informatat se si është organizuar mësimi deri tani dhe si duhet të vazhdojë të organizohet në mënyrë që fëmija të përshtatet sa më shpejt me ambientin e ri dhe të identifikohen nevojat për mbështetjen e nevojshme.

PIA po ashtu në këtë fazë ndihmon shkollën të vlerësojë nëse po i ofron fëmijës mbështetjen e duhur, të përcaktojë objektiva reale, të ndajë përgjegjësitë ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe të ndryshojë apo plotësojë planin në të ardhmen.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Çfarë është PIA?	Plani Individual i Arsimit apo PIA është dokument pedagogjik që hartohet për fëmijët me aftësi të kufizuara, ku planifikohet mësimxënia.
Korniza ligjore:	Plani Individual i Arsimit (PIA) https://kosovo.savethechild-dren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Plani%20Individual%20i%20Arsimit%20dhe%20Udhezuesi%20per%20hartimin%20e%20tij.pdf
Trajnimet:	Trajnimi për PIA Trajnimet për arsimin gjithëpërfshirës
Nevoja për bashkëpunim me...	Mësimdhënësin, mësimdhënësin mbështetës, prindin / kujdestarin ligjor, drejtorin e shkollës dhe fëmijën.
Pse PIA?	Sepse lejon fëmijët me aftësi të kufizuara të përfitojnë maksimalisht brenda mundësive dhe potencialit të tyre, duke ndjekur njëkohësisht kurrikulën e rregullt.
Lidhshmëria me elementet e tjera:	PIA përdoret nga mësimdhënësit, me udhëzimin e Ekipit Vlerësues Komunal. Mësimdhënësit mbështetës dhe prindërit / kujdestarët ligjor luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e PIA-s.

TREGIM RASTI

Një tranzicion i lehtë nga shkolla në shkollë përmes PIA-s

Jona⁵, e cila tashmë është në klasën e gjashtë, para tri vitesh ka ardhur në Prishtinë bashkë me familjen e saj: prindërit dhe vëllain. Familja e saj ka pasur vështirësi të mëdha ekonomike dhe në Janjevë ku kanë kaluar shumicën e jetës, kushtet jetësore u janë vështirësuar tej mase aq sa ata kanë vendosur edhe të largohen e të vijnë në Prishtinë. Një arsye më shume se përse familja ishte zhvendosur kishte qenë edhe gjendja shëndetësore e vajzës, Jona, pasi që ajo është një vajzë me Sindromën Down të shoqëruar edhe me dëmtime të tjera të shumëfishta, ka hasur në pengesa të ndryshme edhe për t'u pranuar në shkollë për të vijuar mësimet. Meqë familja ka pasur informacion se shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Asim Vokshi" në Prishtinë, është një shkollë gjithëpërfshirëse, ata kanë vendosur ta regjistrojnë Jonën në këtë shkollë për të vijuar mësimet.

5 Për shkaqe të ruajtjes së anonimitetit personazhi në rastin e studimit është emërtuar me emër fiktiv, ndryshe nga ai real



©Valbona Makovci

Jona qysh në fillim kur është regjistruar në shkollë është përkrahur në vazhdimësi nga të gjithë të angazhuarit në procesin arsimor të saj. Sapo është vlerësuar nga Ekipi Vlerësues Komunal me kërkesën e menaxhmentit të shkollës, dhe është dhënë konstatimi se Jona duhet të vazhdojë mësimin në klasë të rregullt, mësimdhënësja mbështetëse në bashkëpunim me mësimdhënësen e klasës së tretë ku është vendosur Jona, dhe me njoftim të familjes me anë të takimeve të vazhdueshme, kanë hartuar PIA-n e saj, i cili për t'ia mundësuar arritjet sa më të mëdha në procesin arsimor Jonës, është rishikuar para secilës nga tri periudhat e vitit akademik shkollor në vazhdimësi.

Ambienti i shkollës dhe shoqëria me bashkëmoshatarët e saj e kanë bërë Jonën që shpesh të insistojë që të mos shkoj në shtëpi por të qëndroj akoma në shkollë edhe pas përfundimit të orarit të rregullt. Ajo është angazhuar plotësisht në çdo aktivitet në klasë dhe në shkollë përfshirë programet e ndryshme vjetore si dhe në aktivitetet ekstra-kurrikulare dhe vizitat e ndryshme që janë organizuar përgjatë viteve.

Jona brenda periudhës së përcaktuar ka arritur të realizojë 90% të qëllimeve të vendosura në PIA, dhe tashmë ajo jo vetëm që i njeh shkronjat, por edhe shkruan shumë bukur aq sa fletorja e saj është shembull në shkollën Asim Vokshi, ndërsa dosja e saj përmban edhe shumë punime dore, vizatime shumëngjyrëshe dhe dokumentacion i cili vërteton arritshmërinë e saj në njohjen dhe përdorimin e numrave, kafshëve, orendive, stinëve të vitit dhe ushqimeve e ngjyrave të ndryshme.

Pas tre vjetësh që Jona vazhdoi procesin mësimor në shkollën Asim Vokshi, familja vendos të kthehet ne Janjevë, pasi që rasti i tyre është shqyrtuar dhe familjes i është siguruar vendbanimi adekuat. Me kthimin e familjes në vendlindje, Jona duhej të vazhdonte procesin arismor, prandaj shkolla Asim Vokshi, përkatësisht drejtoresha e shkollës, së bashku me mësimdhënësen e klasës dhe mësimdhënësen mbështetëse, kanë ndërmarrur takime të ndryshme, shkëmbim përvojash dhe kanë ofruar ndihmën e tyre ndaj shkollës së re ku do të vazhdonte mësimin Jona, në mënyrë që t'ia lehtësojnë të gjithë procesin e tranzicionit jo vetëm Jonës dhe familjes së saj por edhe shkollës së re.

Edhe pse tanimë Jona vazhdon mësimin në shkollën tjetër, në qytet tjetër, drejtoresha e shkollës Asim Vokshi na tregon se në mënyrë të vazhdueshme ajo dhe mësimdhënësj mbështetëse me ish-mësimdhënësen e klasës së Jonës interesohen për arritshmërinë dhe procesin arsimor të saj dhe akoma kanë bashkëpunim të vazhdueshëm me menaxhmentin dhe stafin e shkollës në Janjevë.



EKIPI VLERËSUES KOMUNAL

Ekipi Vlerësues Komunal është ekip profesional në nivel komune, roli i të cilit është vlerësimi pedagogjik i nevojave individuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara që vijojnë institucionet arsimore.

KUADRI LEGJISLATIV

Ekipi Vlerësues Komunal funksionon në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHTI-t nr. 07/2012 dhe mbështetur nga UA nr. 16/2017 në të cilat dokumente përcaktohet përbërja e ekipit, përgjegjësitë, vlerësimi, dhe rivlerësimi. Ekipi si i tillë luan rol të rëndësishëm në arritjen e synimeve të arsimit gjithëpërfshirës të parashtruar në strategji dhe politika arsimore në Kosovë. Vlerësimi profesional parashihet edhe në Ligjin 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, neni 41.

MASHTI monitoron rregullisht punën e Ekipeve Vlerësuese Komunale dhe organizon punëtori të vazhdueshme në mes të ekipeve të sapothemeluara dhe atyre me përvojë ku shkëmbejnë përvoja, këshilla, vështirësi dhe metoda për t'i tejkaluar ato. Për më tepër, secila DKA në komunat përkatëse ka zyrtarin për arsim gjithëpërfshirës të cilët janë njëherësh edhe kryesues të Ekipeve Vlerësuese Komunale, gjë që tregon angazhimin e të gjithë akterëve relevant në proces.

HAP PAS HAPI

➤ Përbërja e Ekipit

Sipas këtij udhëzimi, Ekipi Vlerësues Komunal përbëhet nga zyrtari komunal i arsimit gjithëpërfshirës, psikologu, pedagogu/pedagogu special, punëtori social si dhe mësimitdhënësi mbështetës apo udhëtues. Sipas nevojës mund të ftohen anëtarë të tjerë, si: mësimitdhënësi (edukatori/ja) i klasës, eksperti varësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar të fëmijës. Prindi / kujdestari ligjor i fëmijës duhet të jetë prezent dhe konsultativ gjatë gjithë kohës së vlerësimit.

➤ Inicimi i procedurës së vlerësimit

Sipas Udhëzimit Administrativ 07/2012, procedurën për vlerësim pedagogjik të fëmijës mund ta inicioj prindi apo kujdestari ligjor i fëmijës, drejtori i institucionit arsimor ku është i regjistruar fëmija, me kërkesën e mësimitdhënësit apo kujdestarit të klasës, zyrtarit të arsimit gjithëpërfshirës në DKA, Qendres për Punë Sociale apo dhe Qendres së Mjeksisë Familjare. Kjo kërkesë duhet të dorëzohet në DKA dhe duhet të jetë e nënshkruar nga prindi apo kujdestari ligjor i fëmijës, në rastet kur fëmija referohet nga një institucion apo individ për vlerësim pedagogjik.

➤ **Procedura e vlerësimit**

Pas pranimit të kërkesës në DKA, Koordinator i Ekipit Vlerësues në afat prej 15 ditësh nga marrja e kërkesës cakton datën e vlerësimit dhe kryen të gjitha procedurat e vlerësimit. Prindërit / kujdestarët ligjor duhet të marrin pjesë në takimin e ekipit. Shkolla pranon raportin me rekomandime brenda 5 ditësh pas mbajtjes së vlerësimit. Ekipi mbanë procesverbal të rregullt për çdo takim, ku arsyetohen të gjitha vendimet e marra. Drejtori i institucionit arsimor ku fëmija refereohet, është përgjegjës për zbatimin e vendimit. Në rast se ekipi ka shumë kërkesa për vlerësime, atëherë bën listën për vlerësim sipas prioriteteve. Ekipi Vlerësues duhet t'i shqyrtoj të gjitha vendimet e veta së paku një herë në dy vite. Të gjithë ata që kanë kërkuar të bëhet vlerësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ana e ekipit, mund të kërkojnë që rishqyrtimi i vendimeve të bëhet edhe më herët.

➤ **Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit - KNF**

Përpos hartimit të udhëzuesit për ekipet vlerësuese pedagogjike dhe trajnimit të tyre, janë hartuar edhe Instrumentet për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, të bazuara në modelin biopsikosocial të KNF. Këto instrumente i cili ofron kategorizime praktike që mund të përdoren si udhëzues në hartimin e vlerësimeve shumëplanëshe të aftësisë së kufizuar, sepse përmblajnë natyrën komplekse dhe ndërvepruese të përvojave të fëmijëve me aftësi të kufizuar me familjet e tyre. Në këtë mënyrë planifikimi i burimeve dhe shërbimeve për të cilat ka nevojë fëmija është më i lehtë.⁶

➤ **Dhomat miqësore për fëmijë**

Dhomat miqësore për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë hapësira miqësore për fëmijë, në të cilat Ekipi Vlerësues Komunal bënë vlerësimin e funksionimit të fëmijëve. Këto dhoma miqësore janë krijuar në bashkëpunim me DKA, duke rehabilituar dhe mobiluar një hapësirë të veçantë për shfrytëzim nga anëtarët e Ekipit Vlerësues përgjatë vlerësimit të funksionimit të fëmijëve. Këto hapësira mund po ashtu të shfrytëzohen edhe për qëllime të tjera, duke përfshirë sesionet individuale që mësimmshënësit mbështetës realizojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara, takime me prindër të fëmijës me aftësi të kufizuara, dhe qëllime të ngjashme sipas nevojës.

6 Aftësia e kufizuar te fëmijët në Shqipëri: Prevalenca e aftësisë së kufizuar, aksesit të shërbimeve dhe cilësia e shërbimeve, 2018




©Save the Children

Me mbështetjen e Save the Children, dhomat miqësore për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizura janë krijuar në komunat si në vijim: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj. Kosto e intervenimeve nga Save the Children për themelimin e dhomave miqësorë është rreth 5,000 EUR për një dhomë / hapësirë. Intervenimet e realizuara përfshijnë punët rehabilituese; mobilimim me orendi të përshtatshme për nevojat e punës, blerja e materialeve didaktike dhe lodrave edukative. Identifikimi dhe/ apo vlerësimi i nevojave për ndërhyrje si dhe përcaktimi i orendive është bërë nga arkitektë të angazhuar nga Save the Children.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Çfarë është Ekipi Vlerësues Komunal?	Ky ekip në nivel komunal bën vlerësimin pedagogjik të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët janë pjesë e institucioneve arsimore.
Kuadri legjislativ:	Funksionimi i Ekipit Vlerësues Komunal rregullohet me Udhëzimin Administrativ të MASHTI-t nr.07/2012
Përbërja e Ekipit:	Zyrtari komunal i arsimit gjithëpërfshirës, Psikologu, Pedagogu/pedagogu special, Punëtori social, Mësimdhënësi mbështetës apo udhëtues.
Inicimi i procedurës për vlerësim:	Procurën për vlerësim pedagogjik të fëmijës mund ta inicioj prindi apo kujdestari ligjor i fëmijës, drejtori i institucionit arsimor, zyrtari i arsimit gjithëpërfshirës në DKA, Qendra për Punë Sociale apo Qendra e Mjekësisë Familjare.
Procedura e vlerësimit:	Pas pranimit të kërkesës për vlerësim, në afat prej 15 ditësh mbahet takimi për vlerësim, dhe pas këtij takimi në afat prej 5 ditësh dorëzohet raporti vlerësues në shkollë nga Ekipi Vlerësues.
Instrumentet për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara:	Me vendim të MASHTI-t, nr. 2-4601 të datës 26.11.2019, fillon përdorimi i instrumenteve për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Instrumentet janë të bazuara në modelin biopsikosocial të KNF dhe përmbajnë këta formularë: <ul style="list-style-type: none"> - Formulari i raportimit nga shkolla dhe raporti i monitorimit (plotësohet nga shkolla) - Profili i funksionimit të fëmijës dhe Rekomandimet vepruese për shkollën dhe familjen (plotësohet nga Ekipi Vlerësues Komunal)
Dhomat miqësore për fëmijë:	Dhomat miqësore janë hapësira ku Ekipi Vlerësues Komunal bënë vlerësimin e funksionimit të fëmijëve, dhe aktivitete të tjera në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
Lidhshmëria me elementet e tjera:	Ekipi Vlerësues përcakton nëse një fëmijë duhet të punoj me PIA apo jo. Ekipi vlerësues ka bashkëpunim me mësuesin(edukatoren) e klasës, prindin dhe mësimdhënësin mbështetës.



©Valbona Makovci

TREGIM RASTI

Puna e Ekipi Vlerësues

Ekipi Vlerësues në komunën e Gjilanit është krijuar në vitin 2014. Ky ekip komunal përbëhet nga zyrtarja për fëmijë me aftësi të kufizuara në komunën e Gjilanit, njëkohësisht kryetare e ekipit; psikologu; dy mësimdhënëse mbështetëse; pedagogjja speciale dhe punëtorja sociale.

Ekipi nga Gjilani karakterizohet me vullnet të madh për punë, profesionalizëm si dhe komunikim korrekt dhe të vazhdueshëm. Ky ekip ka marrëdhënie të shkëlqyera me mësimdhënësit dhe prindërit, të cilët ndjehen të lirë të kontaktojnë këdo nga ekipi për çdo çështje që mund të kenë për diskutim apo këshillim.

Nga Ekipi Vlerësues i Gjilanit kuptojmë rëndësinë e udhëheqjes së ekipit dhe mbështetjes së vazhdueshme që marrin anëtarët e tjerë gjatë punës së tyre. Udhëheqja e mirë e ekipit ka rezultuar në bashkëpunim të mirëfilltë të ekipit dhe suksese të njëpasnjëshme. Ekipi ka vendosur bashkërisht që formë primare e komunikimit të jetë grupi në Viber, në të cilën diskutohet data dhe vendi i takimeve për vlerësim. Pas vendimit që merret në grupin Viber, kryetarja dërgon emailin zyrtar me të gjitha detajet, duke përfshirë në email edhe drejtorët e institucioneve prej nga janë anëtarët, në mënyrë që të jenë të njoftuar për mungesën e tyre në punë. Kjo mënyrë e komunikimit siguron pjesëmarrjen e secilit anëtarë në takim.

Takimet e Ekipit Vlerësues mbahen në dhomën miqësore për fëmijë brenda shkollës “Selami Hallaqi”, mirëpo ka raste kur Ekipi udhëton edhe nëpër fshatra për shkak të përshtatshmërisë së rastit. Ekipi realizon takime sa më parë që të jetë e mundur dhe asnjëherë nuk shkelet afati 15 ditësh nga parashtrimi i kërkesës. Në rastet kur ka numër të madhë të fëmijëve për vlerësim, ekipi vendos rradhitjen me anë të prioritizimit të rasteve urgjente.

Më 2016, një vajzë 8 vjeçare nga një fshat i Gjilanit është identifikuar nga DKA që nuk vijon mësimin në asnjë shkollë, për shkak të gjendjes së saj shëndetësore. Pasi që ekipi ka diskutuar me prindërit e saj, ata janë bindur që vajza e tyre duhet të shkojë në shkollë. Kështu Ekipi Vlerësues ka bërë vlerësimin e saj dhe vajza është vendosur të vijoj vitin shkollor 2017/18 në klasë të bashkëngjitur në klasën e parë. Transporti i vajzës është siguruar nga komuna. Për një vit mësimdhënësja mbështetëse ka punuar me të për çdo ditë nga një orë. Këtë vit, vajza vijon mësimin në klasën e katërt në klasë të rregulltë, ku është ambientuar shumë mirë me mjedisin shkollor, si dhe më shoket dhe shoqet.

Gjithashtu janë edhe dy raste të fëmijëve që kanë përfunduar klasën e nëntë në klasa të rregullta, dhe pas rivlerësimit, ata kanë pranuar raport për të vazhduar mësimet në shkolla të mesme. Po ashtu ekipi bënë rekomandime për ata persona me aftësi të kufizuara që dëshirojnë të ndjekin edukimin jo-formal. Ekipi Vlerësues angazhon mësimdhënësit mbështetës për t’iu asistuar nxënëse me aftësi të kufizuara kur ata kanë testin e arritshmërisë dhe atë të maturës.

Sigurisht që ekipi përveç rezultateve evidente kanë edhe sfida të ndryshme gjatë punës, por të gjitha këto i tejkalojnë duke u mundur t’i përshtaten mundësive ekzistuese, dhe t’i shfrytëzojnë ato maksimalisht. Ata gjithmonë mundohen të konkretizojnë gjithçka, në mënyrë që të jetë sa më e lehtë për mësimdhënësit dhe prindërit që të punojnë me rastet e caktuara. Ekipi jep udhëzime profesionale dhe të përshtatshme për gjendjen e fëmijës. Ata i njoftojnë prindërit me planin PIA dhe rëndësinë e tij. Ata pranojnë dhe japin ide dhe këshilla, duke pasur gjithmonë prioritet shëndetin dhe mireqenien (dhe arritjen arsimore) e fëmijës. Rekomandimet e tyre fokusohen në eliminimin e pengesave dhe fuqizimin e lehtësuesve brenda kontekstit ku fëmija mëson.



INDEKSI PËR GJITHËPËRFSHIRJE

Indeksi për Gjithëpërfshirje përdoret në shumë vende të botës si instrument lehtësues dhe i përshtatshëm i cili iu ndihmon shkollave të zhvillohen me frymë gjithëpërfshirëse dhe i udhëzon ato se si të krijojnë mjedise miqësore dhe gjithëpërfshirëse të mësimnxënies për të gjithë. Këtë mëton ta arrij duke angazhuar mësimdhënësit në krijimin e komuniteteve përkrahëse dhe bashkëpunimin e ngushtë në mesin e stafit të shkollave, nxënësve, edukatoëve dhe prindërve të nxënësve.

Indeksi për Gjithëpërfshirje është përshtatur kontekstit dhe nevojave të arsimit dhe ka filluar të përdoret edhe në Kosovë që nga viti 2007 me përkrahjen dhe përkthimin e Save the Children ndërsa nga viti 2010 Indeksi është shpërndarë në MASHTI, DKA-të përkatëse dhe shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Kosovë.

KUADRI LEGJISLATIV

Indeksi për Gjithëpërfshirje është përfshirë në kuadrin e Strategjisë për Arsimin Para-Universitar 2011-2016 pas përpjekjeve dhe bashkëpunimit të ngushtë të Save the Children me MASHTI-n.

HAP PAS HAPI

Në mënyrë që të zbatohet në përpikmëri dhe të jetë një instrument sa më frytdhënës, Save the Children përveç përkthimit të Indeksit për Gjithëpërfshirje dhe avokimit për t'u përfshirë në Strategjinë për Arsim Para-Universitar 2011-2016, ka ofruar mundësinë e artë të procesit trajnues të mësimdhënësve për përdorim të Indeksit duke i aftësuar ata që ta përshtasin dhe integrojnë atë edhe në planet zhvillimore vjetore të shkollave.

Ndër të tjera, Indeksi ofron një grup treguesish të cilët i ndihmojnë stafit shkollorë të zhvillojnë një proces të vetë-vlerësimit me qëllim të identifikimit të pengesave në mësimnxënie dhe pjesëmarrje, dhe mënyrës se si mund të kapërcehen ato. Të gjitha këto për të ofruar një mjedis të sigurtë, gjithëpërf-

shirës, të harmonishëm dhe përkrahës për nxënësit të cilët kanë stile të ndryshme të nxënies dhe nevoja të veçanta arsimore.

Indeksi në filozofinë e tij përmban tri dimensione themeltare: (1) Krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse, (2) Krijimin e politikave gjithëpërfshirëse, si dhe (3) Krijimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Për të siguruar këtë një shkollë duhet t'i nënshtrohet procesit gjithëpërfshirës i cili përmban pesë faza: fillimin e punës me indeks, informatat për shkollën, hartimin e planit të shkollës për përfshirje në shkollim, prioritetet për zbatim dhe shqyrtimin e procesit të udhëzuesit / vlerësimi.

Secila fazë e veçantë përmban dhe aktivitetet hap pas hapi se si duhet të realizohet:

Faza 1 - Fillimi i punës me Indeks (gjysma e gjysmëvjetorit):

- Formimi i grupit bashkërendues – koordinues;
- Shqyrtimi i qasjes në zhvillimin e shkollës;
- Analizimi i njohurive ekzistuese duke i përdorur nocionet dhe kornizën për shtjellim;
- Thellimi i analizës duke i përdorur treguesit dhe pyetjet;
- Përgatitja për të punuar me grupe të tjera.

Faza 2 - Marrja e informatave për shkollën (një gjysmëvjetor):

- Shtjellimi i njohurive të punonjësve;
- Shtjellimi i njohurive të nxënësve;
- Shtjellimi i njohurive të prindërve / kujdestarëve dhe anëtarëve të bashkësisë;
- Caktimi i prioriteteve për zhvillim.

Faza 3 - Hartimi i planit gjithëpërfshirës për zhvillimin e shkollës:

- Revidimi ose krijimi i planit gjithëpërfshirës zhvillimor të shkollës;
- Analizimi dhe caktimi i prioriteteve në planin zhvillimor të shkollës.

Faza 4 - Zbatimi i prioriteteve:

- Zbatimi i prioriteteve në praktikë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Vlerësimi i procesit të udhëzuesit.

Faza 5 - Përcjellja e punës dhe rishikimi (i vazhdueshëm) i procesit:

- Vlerësimi i zhvillimeve;
- Rishikimi i punës me udhëzues;
- Vazhdimi i procesit të udhëzuesit.⁷

Indeksi për Gjithëpërfshirje gjithashtu shërben si hulumtim me anë të anketeve të zhvilluara dhe të implementuara nga vet stafi i shkollës, gjë e cila është një risi për shkollat në Kosovë dhe sjell qasje të re gjithëpërfshirëse qysh me zbatimin e tij ku bashkëpjesëmarrës në ndarjen e mendimeve dhe qëndrimeve janë mësimitdhënësit, prindërit dhe nxënësit.

MASHTI gjithashtu e ka konsideruar Indeksin për Gjithëpërfshirje si instrument thelbësor, shumëfunksional dhe shumë-dimensional i cili mund të shfrytëzohet edhe për vlerësimin e performancës së shkollave dhe lehtësimin e përpilimit të planit zhvillimor të tyre. Në Kosovë është filluar të punohet me Indeksin për Gjithëpërfshirje që nga viti 2003, por qëndrueshmëria e zbatimit të tij është një dimension i cili kërkon shumë përkushtim dhe angazhim të të gjithë akterëve, e në veçanti të menaxhmentit të shkollave.

⁷ Indeksi për gjithëpërfshirje – fakte dhe opinione: Dr. Naser Zabeli & Ma. Lulavere Behluli, Dhjetor 2014

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Çfarë është Indeksi për Gjithëpërfshirje?	Instrument lehtësues dhe i përshtatshëm i cili iu ndihmon shkollave të zhvillohen me frymë gjithëpërfshirëse dhe i udhëzon ato se si të krijojnë mjedise miqësore dhe gjithëpërfshirëse të mësimnxënies për të gjithë.
Kuadri Legjislativ:	Indeksi për Gjithëpërfshirje është përfshirë në kuadrin e Strategjisë për Arsimin Para-Universitar 2011-2016 pas përpjekjeve dhe bashkëpunimit të ngushtë të Save the Children me MASHTI-n.
Fazat e zhvillimit të Indeksit:	<p>Faza 1 - Fillimi i punës me Indeks</p> <p>Faza 2 - Marrja e informatave për shkollën</p> <p>Faza 3 - Hartimi i planit gjithëpërfshirës për zhvillimin e shkollës</p> <p>Faza 4 - Zbatimi i prioriteteve</p> <p>Faza 5 - Përcjellja e punës dhe rishikimi i vazhdueshëm i procesit</p>
Pjesëmarrësit në zbatim:	<p>Stafi i shkollës duke përfshirë menaxhmentin dhe mësimdhënësit të cilët formojnë grupin punues.</p> <p>Mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit anketohen dhe shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre.</p>
Kohëzgjatja:	5 fazat e Indeksit kryhen brenda vitit akademik, ku faza 1 dhe 2 zbatohen në gjysëmvetorin e parë (me kurrikulën e re në tre mujorit e parë), faza 3 dhe 4 përgjatë gjysëmvetorit të dytë (tre mujorit të dytë dhe të tretë) ndërsa faza 5 zhvillohet në vazhdimësi të procesit.
Lidhshmëria me elementet e tjera:	<p>Mësimdhënësit e angazhuar rreth Indeksit duhet të jenë të trajnuar në këtë fushë në mënyrë që Indeksi të zbatohet në përpikmëri.</p> <p>PIA duhet të gjej zbatim dhe bashkëpunimi me prindërit është kyç në mënyrë që të nxirren edhe qëndrimet dhe kontributi i tyre në përmirësimin e ambientit shkollor.</p>

arsimor në shkollë dhe aktiviteteve të zhvilluara dhe ndihen se kanë rol më të rëndësishëm në arsimimin dhe shkollën e fëmijëve të tyre.

Nga ana tjetër, mësime të mëdha të lehtë të evidentojnë fushat ku ka nevojë për intervenime dhe të ndërmarin hapa konkret për përmirësimin e gjendjes duke zhvilluar aktivitete të ndryshme ekstra-kurrikulare në shkollë me tema të caktuara, si p.sh.: dhuna në shkollë dhe parandalimi saj; ngacmim i bashkëmoshatarëve (bulizmi); etj. Përgjatë javës kur është bërë intervistimi në shkollë, mësime të mëdha të bashkuar me mësime të mbështetëse ishin në përgaditje e sipër të diskutimit të hapur dhe aktiviteteve të ndryshme brenda shkollës me temën e dhunës në shkollë më të dy ciklet e shkollës. Kjo nevojë, ndër të tjera, është e evidentuar nga Indeksi për Gjithëpërfshirje i cili është zbatuar vitin e kaluar ndërsa prioritetet e dala janë përfshirë edhe në planin zhvillimor të shkollës.

Pra në përgjithësi si rezultat i Indeksit janë shtuar aktivitetet në shkollë dhe kjo është e evidentueshme pasi që takimet bashkëpunuese ndërmjet mësuesve mes vete por edhe me prindër janë shpeshtuar dhe temat e diskutuara janë gjithnjë në rritje dhe përfshijnë çështje siç janë hapat konkret se si të lehtësohet edhe më tutje gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasa të rregullta e deri tek puna më efektive dhe efektive me PIA.

Nxënësit gjithashtu kuptojnë se janë një hallkë e rëndësishme dhe me peshë të madhe në procesin arsimor dhe se mendimet, nevojat dhe qëndrimet e tyre mirren parasysh. Ata shprehin se mësime të mëdha janë më të afërt dhe më të hapur për mendimet e tyre dhe përkujdesen që klasa të jetë një ambient i këndshëm, miqësor dhe pranues për të gjithë pa dallime. Nxënësit poashtu shprehin të kënaqur me aktivitetet që zhvillohen në shkollë rreth temave të caktuara pasi që konsiderojnë se mësojnë gjëra të reja të rëndësishme ndërmjet lojërave dhe bashkëpunimit edhe më nxënës të klasave të tjera duke shkëmbyer mendime e përvoja.



PËRMIRËSIMI I PRAKTIKAVE PEDAGOGJIKE NË OFRIMIN E ARSIMIT GJITHËPËRFSHIRËS

Arsimi gjithëpërfshirës në shumë vende të botës është realitet, mirëpo gjatë tërë kohës përcillet me përmirësime të mundshme. Në Kosovë, ashtu siç është cekur më lartë, arsimi gjithëpërfshirës është në proces. Kjo na lë të kuptojmë se duhet punë e vazhduar për të arritur suksesin e duhur tek të gjithë fëmijët.

Në përmirësimin e praktiave pedagogjike hyjnë edhe trajnimet e vazhdueshme që duhet të ndjekin mësimdhënësit në shërbim, si dhe përditësimi i kurrikulës së Fakultetit të Edukimit konform nevojve.

KUADRI LEGJISLATIV

Në Udhëzimin Administrative nr. 6/2017 MASHTI krijon një sistem të sigurimit të cilësisë në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve në funksion të licensimit të tyre në sistemin e arsimit parauniversitar. Në nenin 2 të këtij udhëzimi përkufizohen edhe programet e zhvillimit profesional si trajnime pa shkëputje nga puna, të miraturo nga insitucioni i autorizuar me qëllim të aftësimin të kuardrit të institucioneve arsimore brenda kërkesave të sistemit të licensimit. Ndërsa në nenin 3 përcaktohet detyra e MASHTI-t për të identifikuar nevojat dhe kërkesat për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve.⁸ Në këtë aspekt, MASHTI në vazhdimësi ka luajtur një rol kyç në sigurimin e mundësive për mësimitdhënësit dhe shkollat që të ngrisin kapacitetet e tyre me anë të trajnimeve të ndryshme, në bashkëpunim me GIZ, UNICEF Kosovo, KEC, Save the Children, Këshillin e Evropës, Qendrat Burimore, etj. trajnimet e të cilave janë të akredituara dhe të përfshira në katalogun e programeve dhe të aprovuara për zhvillim profesional të mësimitdhënësve dhe udhëheqësve të arsimit. Të gjitha trajnimet janë zhvilluar në përputhshmëri me planin e veprimit të PSAK dhe në bazë të nevojave të identifikuara.

Fokus të veçantë kanë pasur trajnimet për Inspektor të Arsimit dhe Ekipet Vlerësuese në komunat përkatëse rreth arsimit gjithëpërfshirës sipas 12 moduleve specifike të Save the Children por edhe trajnime të tjera rreth PIA-s dhe Indeksit për Gjithëpërfshirje. Njoftimi dhe familjarizimi me procesin arsimor gjithëpërfshirës dhe me instrumentat përkatës është vlerësuar si tejet i rëndësishëm për inspektimin e duhur dhe cilësor.

Deri më tani më pak se 50 % të mësimitdhënësve të synuar janë bërë pjesë e trajnimeve përkatëse (kualifikim i nivelit të pestë – post sekondar, 120 kredi për staf arsimor – politikë e re e MASHTI-t për vitin 2019), por kjo tregon se duhet ende angazhim që të përfshihen edhe më shumë në të ardhmen.⁹ Në vazhden e kësaj, MASHTI do të angazhohet që të punësoj asistent në shkolla të cilët veçse kanë përfunduar kualifikimin Asistent për Fëmijet me Nevoja të Veçanta.

8 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/6-2017-ua-per-kriteret-dhe-procedurat-e-aprovimit-te-programmeve-per-zhvillim-profesional-te-mesimdhnesve-dhe-punonjesve-arsimor-rotated.pdf>

9 Intervistë me Udhëheqësen e Divizionit për Arsim Gjithëpërfshirës në MASHTI

HAP PAS HAPI

➤ Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve me anë të trajnimeve të akredituara nga MASHTI

Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve është bërë përmes trajnimeve për përgaditjen e PIA-s në veçanti, trajnime rreth zbatimit të Indeksit për Gjithëpërfshirje, pastaj programi i trajnimit me 12 module e ofruar nga Save the Children e cila ka prekur tema kyçe siç janë puna me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar dhe metodologjive se si të përfshihen e fëmijët me aftësi të kufizuara në klasa gjithëpërfshirëse gjatë procesit arsimor si dhe programeve të trajnimeve të licencuara nga MASHTI dhe të ofruara nga GIZ, UNICEF Kosovo, KEC, Këshilli i Evropës, Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim, etj. Disa nga temat e trajtuara në programe janë: hartimi dhe zbatimi i PIA-s; prodhimi i materialit didaktik; qasja metodologjike në mësimdhënie; arsimit gjithëpërfshirës; *fëmijet me autizëm*; *mësimi i shkrimit Brail*; karakteristikat e fëmijëve me dëmtime në të parë; intervenimi i hershëm; trajnime për orientim dhe mobilitet; *përdorimi i teknologjisë informative për të verbër*; shkolla për të gjithë: trajnim hyrës dhe i avancuar.

Për të pasur një pasqyrë më të mirë të programeve të akredituara dhe për ofruesit e tyre sugjerojmë që të interesuarit të shqyrtojnë katalogun e programeve të akredituara dhe të aprovuara për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të arsimit në ueb-faqen apo edhe drejtpërdrejt në objektin e MASHTI-t.

Pasi të jenë konsultuar me katalogun dhe një grup mësimdhënësish kanë vendosur se duan t'i nënshtrohen *trajnim*it/ve të caktuara, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës parashtrojnë kërkesën tek DKA përkatëse. DKA në bashkëpunim me MASHTI-n vendosin për detajet teknike të organizimit dhe mbarëvajtjes së trajnimit.

➤ Programi i trajnimit me 12 module ofruar nga Save the Children në Kosovë

Programi me 12 module për arsimin gjithëpërfshirës ka filluar të ofrohet në vitin 2012 dhe ka vazhduar deri në vitin 2018. Përgjatë periudhës 2012-2015, përfitues të trajnimit kanë qenë edukatorët dhe stafi i institucioneve parashkollore në 7 komunat përfituese të programit të Save the Children (Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjakovë). Ndërsa përgjatë periudhës 2016-2018, përfitues të trajnimeve kanë qenë mësimdhënësit dhe stafi i 7 shkollave përfituese, si dhe anëtarët e Ekipeve Vlerësuese Komonale në 7 komunat e lartëcekura.

Programi 12 modular është i konceptuara në atë mënyrë që të formojë një tërësi të tematikave të nevojshëm që duhet të ketë një mësimdhënës në mënyrë që të formojë një tërësi të njohurive të nevojshëm për të punuar me fëmijë me aftësi të kufizuara. Ky program përfshinë 12 ditë trajnimi me nga 8 orë që do të thotë që çdo pjesëmarrës do të ketë 96 orë trajnimi. Modulet e këtij programi janë si në vijim:

1. Arsimi gjithëpërfshirës në Kosovë, gjendja dhe perspektiva

Ky modul ka si qëllim t'iu ofrojë mësimdhënësve informacione lidhur me gjendjen në Kosovë, ngecjet, të arriturat e shënuara lidhur me arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe njoftimi me politikat që ka zhvilluar MASHTI për të kaluar nga arsimi special në atë gjithëpërfshirës. Në këtë kontekst një rëndësi e veçantë i kushtohet sfidave të cilat i kanë aktualisht institucionet arsimore të cilat po punojnë në drejtim të krijimit të institucioneve arsimore gjithëpërfshirëse dhe përvojat e mira të cilat janë krijuar vitet e fundit.

2. Të drejtat e fëmijës dhe metodologjia e edukimit

Në këtë modul ofrohen informata rreth të drejtave të fëmijës në kontekstin kosovar dhe rolin e shkollës në promovimin e të drejtave të fëmijës. Gjithashtu një hapësirë e veçantë i kushtohet strategjive të mësimdhënies për promovimin e të drejtave të fëmijës.

3. Llojet e dëmtimeve dhe vështirësitë

Në këtë modul trajtohen llojet e dëmtimeve të cilat krijojnë tek fëmijët vështirësi në të nxënë por edhe në adaptimin në ambientet ku ata veprojnë. Përmes trajtimit të hollësishëm të këtyre dëmtimeve do të synohet ndryshimi i qëndrimeve të mësimdhënësit mbi aftësinë e kufizuar dhe të ulen paragjykimet të cilat ekzistojnë tek ata si rezultat i mungesës së njohurive mbi aftësinë e kufizuar.

4. Dëmtimet intelektuale

Ky modul fokusohet në një lloj specifik të dëmtimeve tek fëmijët siç janë dëmtimet intelektuale të cilat paraqesin një për llojeve të cilat kërkojnë fokus të veçantë për shkak të natyrës dhe vështirësisë që mbart më vetë. Mësimdhënësit përveç informacioneve që marrin lidhur me definicionin, llojet dhe shkaqet, një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet veprimeve apo strategjive që duhet të përdorë mësimdhënësi apo edukatori gjatë punës.

5. Sindromi Down

Në këtë modul trajtohet sindromi Down duke përfshirë definicionin, shkaqet, gjendja e fëmijëve me sindromin Down në Kosovë, përfshirja e tyre në institucione arsimore dhe përvojat e mira të cilat janë sot në vendit tonë. Një rëndësi të veçantë i kushtohet metodave dhe strategjive që duhet të përdorë mësimm-dhënësi.

6. Autizmi

Ky modul trajton çregullimet e spektrit autik dhe fokusohet tek shpjegimi i definicionit, llojeve, karakteristikave të autizimit, rolit të shkollës tek këta fëmijë. Një rëndësi e veçantë i kushtohet ofrimit të informacioneve praktike se si duhet të punohet me këta fëmijë për shkak të natyrës specifike të punës të cilën duhet ta bëjë mësimm-dhënësi.

7. Dëmtimet në të dëgjuar dhe në të folur

Ky modul trajton definicionin e dëmtimit në të dëgjuar, shkaqet, shkallët e dëmtimit dhe strategjitë e mësimm-dhënies. Puna më fëmijët me dëmtime në të dëgjuar paraqet një sfidë për mësimm-dhënësit për shkak të gjuhës së shenjave, andaj më këtë nuk synohet t'u mësohet gjuha e shenjave, por rëndësi ka identifikimi i këtyre fëmijëve që kanë nevojë për gjuhë të shenjave dhe referimit tek institucionet të cilat janë të specializuara për punë më këta fëmijë.

8. Dëmtimet në të parë

Ky modul trajton specifikat që kanë fëmijët me dëmtime në të parë duke përfshirë edhe informacione relevante për llojet e dëmtimeve në të parë, shkaqet e dëmtimeve, mënyrat e identifikimit të fëmijëve me dëmtime në të parë, mjetet ndihmese për fëmijët që kanë këtë lloj dëmtimi dhe metodologjitë / strategjitë e punës.

9. Vështirësitë specifike në të nxënë

Në këtë modul mësohen vështirësitë specifike në të nxënë e të cilat kërkojnë njohuri të veçanta nga mësimm-dhënësit se si të identifikohen dhe si duhet t'iu qasën duke përfshirë këtu edhe qasjet e ndryshme praktike të cilat janë të suksesshme për punë.

10. Metodatat e punës sipas llojeve të dëmtimeve

Në këtë modul trajtohen llojet e dëmtimeve duke përfshirë edhe dëmtimet e kombinuara, veprimet / strategjitë që duhet të ndërmerren nga ana e mësimeve sipas llojeve të dëmtimeve.

11. Identifikimi, intervenimi i hershëm dhe planifikimi i punës

Ky modul fokusohet në definicionin e intervenimit të hershëm, arsyet se përse duhet të bëhet intervenimi i hershëm, përfitimet nga ky lloj intervenimi për të ardhmen e fëmijës. Gjithashtu moduli përfshin edhe përvoja praktike të identifikimit të hershëm për planifikim të mëtejshëm të punës me këta fëmijë edhe në të ardhmen.

12. Organizmi i portfolios se fëmijës

Në këtë modul përfshihen aspekte që kanë të bëjnë me përkufizimin e portfolios, si organizohet portfolio, llojet e portfolios dhe aspekte të tjera të cilat tregojnë për rendësinë e mbajtjes së portfolios për fëmijë në mënyrë që të vlerësohet progresi i zhvillimit të tyre por edhe me qëllim të bartjes së informatave mbi zhvillimin e fëmijës me kalimin e tij nga një institucion në tjetrin me qëllim të ofrimit të përkrahjes adekuate sipas nevojave individuale të fëmijëve.

➤ Programi Master për Arsim Gjithëpërfshirës në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës

Në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” për herë të parë është akredituar programi master i studimit “Arsimi Gjithëpërfshirës”, për periudhën tetor 2016 – shtator 2019. Ky program paraqet një mundësi të artë që ka për qëllim ofrimin e mundësisë për avancim profesional të mësimeve të rregullt dhe atyre mbështetës por edhe për ata studentë të cilët do të jenë mësimeve të ardhshëm. Studentët të cilët përfundojnë këtë program ndër tjerash pritet të promovojnë një ambient të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës në shkollë për nxënësit, mësimeve, menaxhmentin e shkollës dhe prinderit / kujdestarët ligjor. Gjithashtu mësimeve të ardhshëm dhe ata në shërbim duhet të tregojnë njohuri dhe aftësi pedagogjike-didaktike për promovimin e të nxënësit bazuar në nevojat individuale të nxënësit dhe menaxhimin e klasave gjithëpërfshirëse.

Lëndët obligative që përfshihen në këtë drejtim janë Arsimi Gjithëpërfshirës dhe Legjislacioni; Bazat e logopedise; Zhvillimi atipik; Laboratori: Ushtrimet / trajnimet në të cilin organizohen në fushat psiko-pedagogjike, metodologjike e

didaktike, sociologjike-antropologjike dhe digjitale e të cilat i'u ndihmojnë studentëve në zhvillimin e materialeve të trajnimit, ndërtimin e mjeteve, në zhvillim të kapacitetit reflektues, kritik dhe përmes punës në grup; Metodologjia e hulumtimit në arsimin gjithëpërfshirës; vështirësitë specifike në të nxënë si dhe përfundimi i praktikës në të gjitha fushat educative.

TREGIM RASTI

Mësimdhënësit: gjithmonë të gatshëm për zgjerim njohurish

Njëra ndër hallkat kyçe për sigurimin e një arsimi gjithëpërfshirës cilësor është edhe përgaditja e duhur e mësimdhënësve të angazhuar në procesin arsimor. Si rrjedhojë, mësimdhënësit/et e angazhuara në shkolla janë bërë pjesë e trajnimeve të akredituara dhe të ofruara nga Save the Children, GIZ, UNICEF Kosovo, KEC, Këshilli i Evropës, Qendrat Burimore, etj.

Pavarësisht se trajnimet janë në baza vullnetare, një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve të shkollave në përgjithësi por edhe i atyre shkollave gjithëpërfshirëse në veçanti kanë shprehur dëshirë dhe përkushtim për t'i ndjekur modulet trajnuese të zhvilluara edhe përgjatë fundjavave. Një element tjetër shtytës është edhe numri i trajnimeve të kërkuara për licencim të mësimdhënësve. Trajnimet variojnë nga ato me kohëzgjatje një-ditore tek ato siç janë për PIA-n e cila zgjat 3 ditë si dhe e Indeksit për Gjithëpërfshirje e cila zgjat 4 ditë.



©Valbona Makovci

Grupi i mësimdhënësve nga SHFMU “Migjeni” në Mitrovicë, shprehin mirënjohjen ndaj ofruesve të trajnimeve në bashkëpunim edhe me MASHTI-n dhe konsiderojnë se përveç njohurive tejet të rëndësishme që ato marrin në trajnime, certifikimi nga MASHTI është një motivim shtesë në përgaditjen profesionale dhe portofoliot e tyre personale.

Mësimdhënëset e SHFMU “Migjeni” janë të vetëdijshme për përgjegjësitë e tyre të shumëfishta dhe si të tilla ato ndërmarrin hapa konkret përkitazi me grupin me të cilin kanë interaksion të përditshëm. Ato janë gjithnjë të kujdesshme dhe angazhohen të sigurojnë dhe ndërmarrin veprimet e mëposhtme në mënyrë të vazhdueshme si: takime dhe bashkëpunim të ngushtë me psikologjen e shkollës në rast se ka, por në raste kur nuk ka, komunikojnë me psikologë që janë në nivle të komunës apo edhe mësimdhënësve me sfond psikologjik; takime të vazhdueshme me prindërit / kujdesarët ligjor për informim, sensibilizim dhe këshillim; takime me nxënësit në klasë më të cilët krijojnë rregullat e përbashkëta të klasës; krijimi i rregullit të uljes në klasë ku çdo muaj bëhet ndërrimi i uljes në banka në mënyrë që secili nxënës të ketë mundësi të ulet me shokun / shoqen e klasës duke përfshirë edhe nxënësit me aftësi të kufizuara, përzgjedhjen dhe vendosjen e punimeve të nxënësve në tabelë – duke përfshirë edhe të nxënësve me aftësi të kufizuara si dhe organizimin e lojërave-aktiviteteve kreative për të përfshirë të gjithë nxënësit brenda klasës, shkollës por edhe jashtë saj me anë të vizitave të ndryshme dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare.

Për të siguruar arsimimin e duhur përkitazi nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara, mësimdhënëset janë të angazhuara qysh nga fillimi në përpilimin e PIA-s në bashkëpunim të ngushtë, të detajuar dhe të vazhdueshëm më mësimdhënësen përkatëse mbështetëse dhe prindërit / kujdestarët ligjor e nxënësit dhe në vazhdimësi ndjekin punën me PIA duke arritur të shënojnë të gjitha arritjet e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe dokumentimit të tyre. Mësimdhënëset hartojnë teste individuale sipas objektivave përkatëse dhe përdorin metodat e duhura me nxënësit. Në këtë linjë mësimdhënëset realizojnë takime të vazhdueshme me prindër / kujdestarë ligjor të evidentuar me listë të takimeve gjatë të cilave diskutohet në bazë të dosjes së nxënësve.

Përveç detyrave dhe përgjegjësi të lartëcekura, mësimdhënëset duke pasur parasysh edhe shkathtësitë e përfituara nga trajnimet janë të angazhuara në mënyrë të vazhdueshme me vetinicitivë në bashkëpunimin me komunitetin e mësimdhënësve në shkollë gjatë të cilave ndajnë përvoja dhe këshillohen me njëra-tjetrën për aktivitete të ndryshme. Gjithashtu ato janë të angazhuara edhe në bashkëpunim të vazhdueshëm me mësimdhënësit/et e ciklit të mesëm të ulët me të cilët sigurojnë vijueshmërinë e duhur të procesit mësimor sipas nevojave individuale të nxënësve.

Nga ky bashkëpunim i ngushtë në mes komunitetit të mësimdhënësve të shkollës në baza vullnetare dhe me mirëkuptim të ndërsjellë është vendosur që dy nga tri mësimdhënëset mbështetëse të angazhohen me nxënësit e nivelit fil-lor ndërsa një mësimdhënëse mbështetëse të mbështesë punën me nxënësit e nivelit të mesëm të ulët në bashkëpunim me mësimdhënësit lendor, në veçanti me ata të matematikës dhe gjuhës (shkrim-leximit). Këto aktivitete të gjitha ndodhin në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin e shkollës dhe në in-formim të vazhdueshëm të prindërve / kujdestarëve ligjor të nxënësve.

Nga trajnimet e ndjekura ato veçojnë rëndësinë dhe nevojën e madhe për t'u prekur edhe më shumë ana praktike dhe konkrete e temave të diskutuara si dhe ofrimi i më shumë metodologjive pedagogjike të punës dhe qasjes ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e tyre. Pavarësisht se ato shprehen se janë jashtëzakonisht më të informuara dhe kompetente për identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara pasi që edhe kanë pasur rastin të identifikojnë dhe referojnë tri raste edhe tek Ekipi Vlerësues Komunal, ato konsiderojnë se duhen edhe më shumë trajnime të akredituara / licencuara të vazhdueshme, të përditësuara dhe rifreskuese të njohurive të tyre të përfituara.

Excellence



MËSIMDHËNËSIT MBËSHTETËS

Roli primar i mësimitdhënës/ës mbështetës/e është identifikimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë në klasat e rregullta në shkolla, me synim të përkrahjes së zhvillimit të potencialit arsimor të atij nxënësi/e.

KUADRI LEGJISLATIV

Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimeve mbështetës janë të përcaktuara dhe të rregulluara me Ligjin nr. 04/2021 për Arsimin Parauniversitar dhe Normativ nr. 05/2021 për kuadrin profesional në arsimin parauniversitar.

HAP PAS HAPI

➤ Mësimdhënësi/ja mbështetës/e

Mësuesi/ja mbështetës/e në bashkëpunim me mësimeve klasor apo edhe kujdestarët e klasave brenda shkollës identifikojnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe më pas, *së bashku edhe me drejtorin/en e shkollës*, informojnë prindërit / kujdestarët ligjor dhe bëjnë referimin e nxënësit/es për vlerësim pedagogjik në Ekipin Vlerësues Komunal.

Poi/e nejt/a, *në bazë të vlerësimit pedagogjik*, harton planin e punës për mbështetje për secilin nxënës dhe organizon aktivitete të përbashkëta bazuar në nevojat e identifikuar të nxënësve. Në rast të vlerësimit nga Ekipi Vlerësues Komunal se nxënësi duhet të ketë PIA, atëherë përpilon PIA-n *në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me mësimeve dhe rregullt, prindin / kujdestarin ligjor dhe anëtarët e tjerët të ekipit për hartimin e PIA-s*, koordinon punën rreth hartimit, zbatimit dhe rishikimit të PIA-së dhe angazhohet për të siguruar mbështetjen dhe shërbimet e nevojshme për nxënës brenda dhe jashtë institucionit shkollor.

Gjithashtu, mësimeve mbështetës asiston në procesin e vetëdijimit të stafit të shkollës për procesin e gjithëpërfshirjes. Këtë e bën kryesisht duke ndërmarr iniciativë të ndryshme siç janë punëtoritë, trajnimet dhe seminarët e ndryshme për vetëdijësim dhe përkrahje të nxënësve me aftësi të kufizuara *në mënyrë që pranimit, mirëpritja dhe ambienti miqësor dhe përkrahës të sigurohet brenda dhe jashtë institucionit shkollor.*

Këshillon dhe ndihmon mësimeve klasor dhe lëndor se si të punojnë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe si të menaxhojnë klasat gjithëpërfshiëse, e në veçanti menaxhimin e punës në grup në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara *në aktivitetet e grupit. Këtë e bën duke hartuar edhe materialet e ndryshme didaktike e mësimore alternative përkitazi me nevojat e nxënësve të cilat përkrahin përfshirjen / avancimin e fëmijës në grup me fëmijët tjerë, sidomos në bashkëpunim edhe me qendrat burimore, qendrat këshilluese dhe OJQ të ndryshme të profilizuara me të cilat po ashtu shkëmbejnë metoda të ndryshme të mësimdhënjes dhe mbështetjes në formë të ndryshme ndaj nxënësve. Ai / ajo gjithashtu siguron se vlerësimi i nxënësve bëhet sipas specifikave të secilit dhe merr pjesë në takimet e rregullta të aktiveve të mësimeve në planifikimin e punës arsimore vjetore, mujore e ditore dhe ofron ide e sugjerime të cilat përkrahin përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në klasë të rregullta.*

Mbi të gjitha, ky profil ka për qëllim identifikimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e rregullta në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta dhe institucione të tjera, si dhe të ndihmoj në integrimin e këtyre fëmijëve nga qendrat burimore në shkollë të rregullt, si dhe nga klasët e bashkangjitura në klasët e rregullta brenda-për-brenda shkollës.

➤ **Mësimdhënësi/ja udhëtues/e**

Ndërsa për dallim nga mësimdhënësit mbështetës, është e rëndësishme të kihet parasysh se mësimdhënësi udhëtues ka për detyrë të "...identifikoj nevojat për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të rregullta. Mësimdhënësi udhëtues identifikon nevojat e mësimdhënësve të shkollave të rregullta për trajnime, si dhe nevojat e shkollave të rregullta për mbështetje me materiale didaktike; bashkëpunon me stafin mësimor, shërbimet e mbështetjes brenda shkollës, profesionistët e tjerë si dhe me prindërit e fëmijëve; ofron mësim shtesë për nxënësit e shkollave të rregullta si dhe trajnime në kuadër të programeve të licencuara të Qendrave Burimore; si dhe mban evidencë mbi numrin e nxënësve të mbështetur dhe për numrin e rasteve të identifikuara."¹⁰

➤ **Asistenti/ja**

Sa i përket rolit të asistentit/es, ai / ajo ka për detyrë të asistoj dhe kujdeset për fëmijët me aftësi të kufizuara gjatë procesit mësimor në institucione arsimore. Asistenca përfshinë qoftë lehtësimin në nevojat fiziologjike, fizike e mjekësore apo / edhe ndonjë asistencë tjetër të cilat fëmijës nuk mund t'ia ofrojë mësimdhënësi. Asistenti i përcaktohet fëmijës vetëm atëherë kur Ekipi Vlerësues Komunal vendos për këtë duke i marrë për bazë nevojat e fëmijës \ nxënësit.

➤ **Edukatorët/et mbështetës/e në insitucionet e edukimit në fëmijëri të hershme**

Në Kosovë, përveç shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, edhe institucionet që ofrojnë shërbime për edukimin në fëmijërinë e hershme që janë publike dhe jo publike, mbështeten nga MASHTI me anë të politikave ndërsa nga DKA – drejtpërdrejt, pasi që edhe janë në kompetencë të tyre.

Sikurse mësimdhënësi/ja mbështetëse në shkolla, edhe edukatori/ja mbështetës/e ka për detyrë koordinimin e punës edukative dhe mbështetjes

10 Doracak mbi gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të vecanta në institucionet arsimore – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjise (MASHT), Handikos dhe Save the Children, Prishtinë 2016.

së institucionit parashkollorë dhe fëmijës, këshillimin dhe mbështetjen e edukatorëve dhe stafit të institucionit përkatës. Po ashtu, ai / ajo bashkëpunon në indentifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe së bashku me edukatorët dhe drejtorinë, informojnë prindërit apo kujdestarët ligjor dhe referojnë fëmijën për vlerësim pedagogjik tek Ekipi Vlerësues Komunal. Me pas ai / ajo harton planin e punës së fëmijës me edukatoren përkatëse, prindërit dhe psikologun përkitazi me vlerësimin e Ekipit Vlerësues.

Po që se paraqitet nevoja e punës me PIA, edukatorja mbështetëse asiston në përpilimin e PIA-s, prodhimin e materialeve shtesë të nevojshëm, si dhe menaxhon punën në grup për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përtej kësaj, ai / ajo bashkëpunon ngusht me OJQ dhe qendrat këshilluese sipas nevojës si dhe ndërmerr iniciativa për vetëdijësim të komunitetit rreth arsimit gjithëpërfshirës brenda dhe jashtë institucionit edukativ.¹¹

Të gjitha trajnimet dhe programet për ngritje të kapaciteteve të ofruara dhe akredituara nga MASHTI vlejnë njëlloj edhe për këtë kategori.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR	
Çfarë është mësimitdhënësi/ja mbështetës/e?	Roli primar i mësimitdhënësit/es mbështetës/e është identifikimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë në klasat e rregullta në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, me synim të përkrahjes së zhvillimit të potencialit arsimor të atij nxënësi/e.
Kuadri legjislativ:	Ligjin nr. 04/2021 për Arsimin Parauniversitar dhe Normativ nr. 05/2021 për kuadrin profesional në arsimin parauniversitar.
Nën patronazhin e:	Mësimitdhënësit mbështetës fillimisht janë financuar nga Save the Children pastaj kanë kaluar nën patronazhin e DKA-ve si staf i rregullt i shkollave dhe pagat e tyre buxhetohen krahas atyre të mësimitdhënëseve të tjerë në komunën dhe shkollat përkatëse.
Bashkëpunim i ngushtë me:	Stafin menaxherial të shkollave, mësimitdhënësit në shkollë, psikologjen dhe pedagogjen, nxënësit dhe prindërit e tyre, Ekipin Vlerësues Komunal, Qendrat Burimore, Qendrat Këshilluese dhe OJQ-të e ndryshme.
Përgatitja e duhur:	Përveç aspektit të sfondit edukativ të mësimitdhënësit mbështetës është e rëndësishme që ata / ato t’iu jenë nënshtruar trajnimeve të ndryshme të hërë-pas-hershme për ngritje të kapaciteteve profesionale.

11 Organizimi i sistemit mbështetës në Institucione edukativo – arsimore: Botimi i broshurës u mbështet nga projekti ‘Mbështetja për Reformën e Arsimit Gjithëpërfshirës 2015’ i financuar nga Ambasada e Finlandës në Prishtinë zbatuar nga organizata KAPIE.

TREGIM RASTI

Mësimdhënësit mbështetës: sigurues të suksesit në arsimin gjithëpërfshirës

SHFMU “Migjeni” në Mitrovicë ka tri mësimdhënëse mbështetëse, dy të angazhuara nga Save the Children dhe një e cila ka qenë e angazhuar fillimisht në kuadër të MASHTI por që tanimë është nën kompetencën e DKA-së.

Profili i mësimdhënëses mbështetëse është njëra ndër ndihmesat më të mëdha të deritanishme të arsimit gjithëpërfshirës në shkollat në Kosovë, e sidomos për mësimdhënëset e klasave të rregullta ku vijnë mësimin edhe nxënësit me aftësi të kufizuara. Përveç kryerjes së përgjegjësive të përcaktuara ato janë të angazhuara intensivisht edhe në zhvillimin e aktiviteteve të shumta ekstra-kurrikulare në shkollë dhe jashtë saj, siç janë aktivitetet e ndryshme për ditën ndërkombëtare të fëmijës, për bulizmin dhe parandlimin e dhunës në shkollë, për gjithëpërfshirjen sociale, etj. si dhe sesione informuese me prindër brenda dhe jashtë shkollës për sensibilizim rreth domosdoshmërisë dhe rëndësisë së arsimit gjithëpërfshirës.

Mësimdhënëset janë tejet falenderuese për mbështetjen e tyre, pa të cilën do ta kishin thuar se të pamundur menaxhimin e klasës dhe ofrimin e një procesi mësimor cilësor qoftë për nxënësit me aftësi të kufizuara, por edhe për të tjerët. Në bashkëpunim me mësimdhënëset mbështetëse, shkolla Migjeni ka siguruar ambient të përshtatshëm për 19 nxënës me aftësi të kufizuara. Ndërsa prindërit e këtyre nxënësve janë shumë të kënaqur me përkujdesin ndaj fëmijëve të tyre, bashkëpunimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me mësimdhënësen e klasës dhe mësimdhënëset mbështetëse në veçanti dhe konsiderojnë se konsultimi me këto të fundit ka ndihmuar dukshëm në arritshmërinë arsimore të fëmijëve të tyre.

Një element i rëndësishëm lehtësues që mësimdhënëset mbështetëse ndërmarrin është edhe identifikimi i nxënësve me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në të nxënë të cilat raste i trajtojnë fillimisht në shkollë e pastaj nëse nevoja është e madhe dhe diagnoza definitive mungon atëherë i referojnë rastet tek Ekipi Vlerësues Komunal, pjesë e të cilës është edhe vet njëra nga mësimdhënëset mbështetëse, element tjetër ky që e lehtëson dhe përshpejton të gjithë procesin e vlerësimit. Si e tillë, ka pasur raste kur nxënësit me aftësi të kufizuara edhe me lejen e prindit është shoqëruar nga mësimdhënësjat mbështetëse për tek Ekipi Vlerësues ku ka bartur informacione të rëndësishme për gjendjen dhe sjelljen e nxënësit të cilat prindërit nuk i kanë vënë re më herët për shkak të ndryshme qofshin ato mungesë informacioni apo në disa raste edhe për shkak të mungesës së përkujdesit adekuat.

Gjithashtu, mësimdhënëset mbështetëse për shkak edhe të përgaditjes së tyre profesionale janë të përfshira në grupin bashkërendues për zbatimin e Indeksit

për Gjithpërfshirje në shkollën Migjeni, ku përveç angazhimit në këtë fushë, kontributi i tyre vërehet dukshëm edhe në përgaditjen e planit zhvillimor vjetor të shkollës dhe vlerësimin e performancës së shkollës.

Mësimdhënëset mbështetëse, ndër të tjera, si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë në mes të komunitetit të mësimdhënësve të shkollës në baza vullnetare dhe me mirëkuptim të ndërsjellë është vendosur që dy nga këto tri mësimdhënëse mbështetëse të angazhohen me nxënësit e nivelit fillor ndërsa një mësimdhënëse mbështetëse të trajtojë nxënësit e nivelit të mesëm të ulët në bashkëpunim me arsimtarët e lëndëve të ndryshme e në veçanti me ata të matematikës dhe gjuhës. Kështu, mësimdhënësja mbështetëse e angazhuar në ciklin fillor punon dhe vëzhgon vijshmërinë e nxënësit A.R i cili në vitin e ardhshëm shkollor do të kaloj në ciklin e mesëm të ulët. Në këtë cikël do të vazhdojë angazhimin dhe mbështetjen e tij dhe të mësimdhënësve të tij mësimdhënësja mbështetëse e ciklit të mesëm të ulët, e cila paraprakisht në bashkëpunim me mësimdhënësen mbështetëse tjetër ka zhvilluar objektiva dhe material të nevojshme didaktike me të cilat do të punojë nxënësi dhe arsimtarët e tij përgjatë vitit të ardhshëm. Pa dyshim që mësimdhënësit përkatës, sidomos ata të lëndëve kyçe, siç janë matematika, gjuha dhe eventualisht ndonjë lëndë tjetër kur nxënësit ka shprehur interes dhe arritje më të kënaqshme dhe është vlerësuar në bazë të PIA-s se ka potencial për të nxënë më shume. Këto aktivitete të gjitha ndodhin në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin e shkollës dhe në informim të vazhdueshëm të prindërve të nxënësve.

Trajnimet e vazhdueshme dhe të përditësuara konform zhvillimeve në fushen e rehabilitimit, shkencës dhe metodologjive inovative arsimore janë një domosdoshmëri sipas mësimdhënësve mbështetëse, pasi që konsiderojnë se sa më të përgaditura të jenë ato dhe komuniteti i mësimdhënësve, aq më lehtësisht do të sigurohet arsimi cilësor dhe gjithpërfshirës në kohë më të shpejtë për nxënësit që u nevojitet. Ato gjithashtu konsiderojnë se trajnimet e tilla nuk janë të domosdoshme vetëm për mësimdhënëset e ciklit fillor por gjithashtu janë të nevojshme dhe të mirëpritura edhe nga mësimdhënësit e ciklit të mesëm të ulët.



IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE JASHTË SHKOLLAVE & FUSHATAT SENSIBILIZUESE PËR REGJISTRIM TË NXËNËSVE

KUADRI LEGJISLATIV

Në Kosovë arsimit parauniversitar për të gjithë pa dallim është i obliguar me ligj. Me udhëzimin e fundit administrativ 08/2018 nga MASHTI për themelimin dhe fuqizimin e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, sigurohet tutje obligueshmëria e prezencës së çdo fëmije në shkollat kosovare, pa dallim.

Pra, të gjitha ligjet, udhëzimet administrative, planet strategjike dhe dokumentacion tjetër në dispozicion kanë për qëllim sigurimin se asnjë fëmijë nuk mbetet i përjashtuar nga sistemi arsimor parauniversitar në Kosovë.

HAP PAS HAPI

Duke pasur kuadrin legjislativ në fuqi si parakusht për arritje të rezultateve, atëhere ngelet për t'u bërë vetëm edhe angazhimi i duhur, me ç'rast duhen përfshirë të gjitha palët e interesit të përfshira në procesin arsimor sidomos në aspektin e ngritjes së ndërgjegjësimit të shoqërisë së gjerë me anë të fushatave për identifikimin e fëmijëve jashtë procesit arsimor dhe regjistrimin e tyre në institucione shkollore.

Si e tillë, janë ndëmarrur disa hapa konkret të rëndësishëm në këtë drejtim duke filluar nga MASHTI e cila konsideron se element tejet i rëndësishëm është edhe angazhimi dhe përfshirja e i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në kuadër të kësaj, Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar me mbështetje dhe pjesëmarrje edhe të MASHTI-t ka organizuar tryeza të rrumbullakëta në 14 komuna të Kosovës ku të ftuar kanë qenë prindërit dhe tema të diskutuara kanë qenë arsimi në përgjithësi ndërsa ai gjithëpërfshirës në veçanti. Sipas Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar (FKAK) "fëmijet me aftësi të kufizuara duhet të jenë pjesëtarë aktiv të shoqërisë dhe kanë të drejtë të marrin mbështetjen e nevojshme për edukim, zhvillim dhe avansim, krahas fëmijëve të tjerë. Një identifikim i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara krijon kushtet për një arsimim më të përshtatshëm". Në lehtësimin e arritjes së këtij qëllimi, FKAK ka lansuar edhe platformen digjitale të regjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë të inkuadruar në procesin arsimor në shkolla. Platforma është digjitale në mënyrë që ta lehtësojë procesin e regjistrimit dhe mund të gjendet në linkun e paraqitur këtu: <http://kdf-ks.org/regjistro/>.

Për t'u arritur rezultat sa me i lartë në identifikimin e fëmijëve që nuk janë përfshirë në sistemin arsimor dhe për t'i përfshirë ata, rol kyç luan bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe organizatave të ndryshme jo-qeveritare të cilat punojnë në këtë fushë, siç bie fjala organizata Nevo Koncepti, Balkans Sunflowers Kosova, RROGRAEK, HandiKOS, etj. të cilat kanë programe të veçanta për identifikimin e fëmijëve të grupeve të ndryshme të marginalizuara të cilët nuk janë të përfshirë në sistemin arsimor në Kosovë.



©Valbona Makovci

Elementi tjetër kyç i cili duhet doemos të ceket është edhe ai i mësimdhënëseve të shkollave, një numër i të cilave janë të angazhuara në grupin koordinues dhe bashkërendues të Indeksit për Gjithëpërfshirje në shkollë ndërsa një numër tjetër të cilat janë edhe pjesë e aktiveve profesionale dhe Ekipeve për Parandalim të Braktisjes dhe Mosregjistrimit brenda shkollës (EPRBM) janë tejet të angazhuara edhe në identifikimin e rasteve të fëmijëve jashtë shkollave të cilat nuk janë të regjistruar në procesin arsimor të rregullt. Përveç që angazhohen në mbarëvajtjen e procesit mësimor përbrenda shkollës, mësimdhënësit ka raste kur për të mirën e fëmijës dalin edhe përtej mandatit të tyre dhe kryejnë vizita dhe takime me prindër në shtëpi për t'i bindur rreth çështjeve të ndryshme rreth procesit arsimor të fëmijëve / nxënësve. Kjo lehtësohet tutje edhe me mbështetjen dhe punën e mandatuar të EPRBM të cilat në bashkëpunim me shkollën, prindërit e fëmijëve, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore, sipas nevojës, i trajtojnë rastet e ndryshme.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Çfarë është identifikimi i fëmijëve jashtë shkollave?	Sipas ligjit Kosovar për arsim parauniversitar, të gjithë fëmijët pa dallim janë të obliguar të vijnë në institucione shkollore. Këtë obligim parimisht e bartin prindërit apo kujdestarët e fëmijëve, mirëpo ka raste që për arsye të ndryshme, fëmijët nuk vijnë në shkollë, me ç'rast institucionet shtetërore në bashkëpunim me shkollat dhe organizatat e shoqërisë civile zhvillojnë fushata të ndryshme për identifikimin e rasteve të tilla dhe ndërmarrjen e hapave konkret në regjistrimin e tyre në shkollë konform dispozitave ligjore.
Kuadri legjislativ:	<ul style="list-style-type: none">- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë.- Korniza Kurrikulare e Kosovës.- UA 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar.
Bashkëpunim i ngushtë mes:	Ekipit për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit së shkollës (EPRBM), stafit menaxherial të shkollave, mësuesit në shkollë, psikologut dhe pedagogut ku është e nevojshme, prindërit apo kujdestarët e fëmijës / nxënësit, organizatave të shoqërisë civile.

NDËRLIDHJET MES SHKOLLËS, DKA-ve, MASHTI-t, OSHC-ve DHE KOMUNITETIT

Rëndësia e partneritetit në mes shkollave – fëmijëve, komunitetit, Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Qeveritare

Gjatë vizitave në terren është parë rëndësia e madhe e partneritetit në mes të shkollave, fëmijëve, komunitetit, organizatave të shoqërisë civile si dhe institucioneve qeveritare dhe lokale të arsimit.

Mësimdhënësit kanë vënë theks të veçantë mbi mbështetjen që marrin nga udhëheqja e shkollës, që ndihmon jashtëzakonisht shumë procesin e gjithëpërfshirjes. Ata tregojnë si drejtorët e tyre janë gjithmonë të informuar për secilin fëmijë me aftësi të kufizuara në shkollën e tyre. Ata po ashtu ndihmojnë në hartimin e PIA-s si dhe sigurojnë që po zhvillohet çdo aktivitet i paraparë. Drejtorët inkurajojnë mësimdhënësit të ndjekin trajnimet të cilat mund të ju ndihmojnë atyre për të përmirësuar qasjen e tyre apo për të përditësuar metodologjinë e mësimdhënies, në veçanti për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Bashkëpunimi me prindërit / kujdestarët ligjor luan rol kyç në mënyrë që procesi i mësimnxënies të vazhdohet edhe në shtëpi, duke ditur që me anë të përsëritjes arrihet më shumë sukses. Prindërit / kujdestarët ligjor gjithashtu shprehin interesim të vazhdueshëm për të punuar me PIA. Ata e shohin PIA-n si një instrument shumë të mirë për të parë progresin e fëmijëve të tyre, dhe angazhohen vazhdimisht me udhëzimet e mësimdhënësve që të arrijnë objektivat e përcaktuara.

Shkollat mohojnë të kenë përkrahje direkte nga MASHTI apo dhe DKA-të, por angazhimi i tyre indirekt është vlerësuar. Shkollat theksojnë se duhet të ekzistojnë një qasje më miqësore në mes tyre dhe institucioneve shtetërore në mënyrë që të shprehin dhe të diskutojnë të gjitha problemet dhe sfidat që hasin gjatë procesit të arsimit gjithëpërfshirës. Shkollat dëshirojnë të kenë raporte dhe

vizita të shpeshta nga institucionet relevante për të parë më afër gjendjen dhe për të marr këshilla dhe instruksione më të drejta. Si praktikë e mirë për adresimin e këtyre çështjeve, shkëmbimin e përvojave, sfidave dhe tejkalimin e tyre, konsiderohen takimet në mes stafit të shkollave gjithëpërfshirëse të paktën dy herë përgjatë vitit.

Shkollat janë mirënjohëse për kontributin e dhënë nga OSHC-të dhe donatorët, e posaqerisht nga Save the Children, ku falë së cilës janë angazhuar mësimdhënësit mbështetës. Gjithashtu shkollat janë shprehur shumë të kënaqshme me nivelin e vetëdijësisimit të nxënësve për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe për mbështetjen e vazhdueshme që ata iu japin fëmijëve në nevojë. Është vlerësuar lartë po ashtu edhe bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe asistenca e ofruar në raste specifike nga Qendrat Burimore, qendrat e këshillimit, organizata PEMA, organizata Down Syndrome Kosova, Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar dhe HandiKOS.

TREGIM RASTI

Të gjithë për Një, sepse Një është po aq i rëndësishëm sa të gjithë

Sikur edhe një fëmijë i vetëm të mbetet jashtë procesit arsimor, për çfarëdo arsye, është humbje e madhe jo vetëm për fëmijën dhe familjen e tij / saj por për të gjithë shoqërinë. Prandaj është e rëndësishme që kur kemi të bëjmë me raste të tilla apo me raste që kanë potencial të shëndrrohen të tilla, të bashkohen të gjithë palët e interesit të përfshira dhe të parandalojnë një gjë të tillë.

Ka shembuj të shumtë të cilët ilustrojnë se si bashkëpunimi i mirëfilltë i të gjithëve siguron gjithëpërfshirje në procesin arsimorë pavarësisht vështirësive dhe sfidave të lloj-llojshme. Disa nga rastet e ndryshme janë ato të shkollës “Asim Vokshi” në Prishtinë ku EPRBM ka ndërhyrë, shkollës “Ibrahim Fehmiu” në Prizren dhe “Zekeria Rexha” në Gjakovë të cilat bashkëpunojnë me organizatën Nevo Koncepti për identifikimin e fëmijëve jashtë procesit arsimor dhe bëjnë fushata për regjistrim të tyre, dhe organizatës HandiKOS në Mitrovicë e cila ndihmon shkollat dhe Ekipin Vlerësues Komunal për t’i identifikuar rastet.

Një element i rëndësishëm i cili vlen të ceket është ai i mësimdhënësve të shkollës “Asim Vokshi” në Prishtinë që plotëson modelin e mësimdhënësve gjithëpërfshirës, një numër i të cilave janë të angazhuara në grupin koordinues dhe bashkërendues të Indeksit për Gjithëpërfshirje në shkollë ndërsa një numër tjetër i të cilëve janë edhe pjese e aktiviteteve profesionale dhe ekipit për parandalim të braktisjes së shkollës (EPRBM). Ata janë tejet të angazhuara edhe në identifikimin e rasteve të fëmijëve jashtë shkollave të cilat nuk janë të regjistruar në procesin arsimor të rregullt. Përveç që angazhohen në mbarëvajtjen e procesit mësimor përbrenda shkollës ato ka raste kur për të

mirën e fëmijës dalin edhe përtej mandatit të tyre dhe kryejnë vizita dhe takime me prindër në shtëpi për t'i bindur rreth çështjeve të ndryshme rreth procesit arsimor të fëmijëve / nxënësve siç edhe ka ndodhur me familjen e dy nxënësve, vëlla e motër, që të dy me aftësi të kufizuara, familja e të cilëve ka bërë rezistencë ndaj dërgimit të tyre në shkollë.

Edhe pse prindërit janë ftuar në shkollë për të bashkëbiseduar jashtë orarit mësimor por edhe në mbledhje të prindërve, ata nuk kanë shkuar. Pas disa tentimeve, mësimdhënësja e klasës së bashku me dy anëtarë të EPRBM kanë shkuar në shtëpinë e familjes dhe pas tre takimeve të vazhdueshme kanë mundur ta bindin familjen që t'i dërgojnë fëmijët në shkollë. Duke qenë se familja ka pasur edhe vështirësi ekonomike dhe sociale është angazhuar edhe qendra e punës sociale dhe shkolla ka vendosur që të ndërmarr aksion për mbledhjen e fondëve për t'i ardhur në ndihmë familjes në fjalë. Tashmë të dy fëmijët vazhdojnë procesin mësimorë në shkollë, dhe prindërit e tyre janë vizitorë të rregullt në mbledhjet e prindërve dhe takimet e tjera brenda dhe jashtë shkollës.

Shkollat “Zekeria Rexha” në Gjakovë dhe “Ibrahim Fehmiu” në Prizren në anën tjetër kanë bashkëpunim të ngushtë me organizata të ndryshme por në veçanti me Nevo Koncepti-n e cila organizon orë plotësuese dhe shitesë sidomos me nxënësit me vështirësi në të nxënë sidomos me fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, e që gjithashtu zhvillon fushata të shumta të identifikimit të fëmijëve të paregjistruar në shkolla dhe regjistrimin e tyre. Nevo Koncepti me metodologji të ndryshme me anë të lojërave pedagogjike dhe edukative identifikon fëmijët që nuk vazhdojnë shkollën, mban evidencën, zhvillon takime të drejtëpërdrejta me familjet e fëmijëve dhe më pas i bart këto informacione te shkolla përkatëse. Pas kësaj procedohen procedurat e regjistrimit të fëmijëve, pasi që ka raste kur fëmijët nuk janë të regjistruar as në komunë dhe nuk kanë mjete identifikimi, prandaj Nevo Koncepti bën edhe lëhtësimin dhe asistimin në këto procedura të familjeve, sidomos të atyre të rikthyera nga migrimi. Raste të tilla të ngjashme ka shumë në të dy komunat, prandaj edhe bashkëpunimi në mes të shkollave dhe organizatës është i vazhdueshëm dhe intensiv.

Ndërsa HandiKOS në Mitrovicë një ndër aktivitetet e saj ka edhe identifikimin e rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët nuk vijnë procesin mësimor. HandiKOS është përkujdesur për një rast më specifik të një vajze të moshës 9-vjeçare në një fshat të Mitrovicës, për të cilën është njoftuar punëtorja e HandiKOS nga një banor i lagjes së familjes së vajzës. Me të marrur informacionin, punëtorja e HandiKOS ka vendosur ta vizitojë familjen dhe të interesohet rreth specifikave të rastit. Pas bisedimeve me familjen, punëtorja ka njoftuar Ekipin Vlerësues Komunal me ç'rast ata kanë shkuar tek shtëpia e familjes dhe kanë bërë vlerësimin e vajzës. Sipas udhëzimit të ekipit, vajza është regjistruar në Qendrën Burimore për një vit e më pastaj është rekomanduar të vazhdohet me regjistrim në shkollë të rregullt. Megjithatë, njëra nga shkollat nuk ka pran-

ar që vajza të regjistrohet prandaj është tentuar të regjistrohet në një shkollë tjetër më gjithëpërfshirëse, shkollë kjo në të cilën vajza tashmë vijon mësimin me anë të PIA-s. Gjithashtu, komuna siguron transportin e vajzes në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, ndërsa vijueshmëria e saj përveç se nga shkolla, monitorohet here-pas-here edhe nga HandiKOS, organizatë kjo e cila shumë shpesh gjithashtu bën edhe lehtësimin e kalimit të fëmijëve nga Qendrat Burimore në shkolla të rregullta e sidomos me anë të asistimit në përpilimin dhe zbatimin e PIA-s.

Si përfundim, vijueshmëria e suksesshme e procesit arsimor parauniversitar e të gjithë fëmijëve pa dallim është qëllim mbarëkombëtar në të cilin duhe të kontribuojnë të gjitha palët e interesit të përfshira. Shembuj si ata të lartëshënuarit tregojnë se është e mundur pavarësisht sfidave dhe vështirësive.


SI TË BËHEMI SHKOLLË PËR TË GJITHË?

➤ Shkolla Ideale (praktikat e mira nga shkollat e intervistuar)

Shkollat gjithëpërfshirëse sigurojnë themelin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Këto shkolla ndihmojnë zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës, që respekton dhe vlerëson diversitetin, promovon pranimin e njëri-tjetrit, si dhe siguron arsim cilësor në ambient të përbashkët mësimor për të gjithë nxënësit pa asnjë dallim.

Shkollë e tillë është edhe SHFMU “Ibrahim Fehmiu” në Prizren me dy mësimdhënëse mbështetëse, të cilët së bashku me 25 mësimdhënëse të ciklit të ulët kanë përfunduar trajnimin me 12 module, përveç trajnimeve të tjera të ndryshme përfshirë dhe atë për Indeksën për Gjithëpërfshirje dhe atë për PIA. Shkolla është jashtëzakonisht mbështetëse për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Shkolla ka krijuar një hapësirë enkas për prindërit / kujdestarët ligjor, të cilët mund të rrijnë aty përderisa presin fëmijët që të përfundojnë mësimin. Ky ambient iu ka mundësuar atyre që të komunikojnë më shumë me njëri-tjetrin dhe të ndjehen më të mbështetur.

Shkolla ka ambient të qasshëm, të dashur dhe të këndshëm për fëmijët. Çdo herë fëmijët me aftësi të kufizuara vijnë në katin e parë të shkollës, për arsye të qasjes më të lehtë dhe përcjelljes së gjendjes nga ana e mësimdhënësve dhe akterëve të tjerë të përfshirë në arsimin gjithëpërfshirës. Shkolla po ashtu ka kontribuar edhe në ngritjen e vetëdijësitë tek fëmijët dhe prindërit për arsimin gjithëpërfshirës me anë të aktiviteteve të ndryshme.



©Valbona Makovci

➤ **Plani Individual i Arsimit**

Plani Individual i Arsimit është instrument i rëndësishëm i suksesit të një fëmije me aftësi të kufizuara. Si i tillë, ky plan duhet të hartohet sipas udhëzimit përkatës dhe të zbatohet në përpikmëri. Në shkollën “Ibrahim Fehmiu”, PIA gjen zbatim të plotë në të gjitha rastet ku ky plan kërkohet.

➤ **Indeksi për Gjithëpërfshirje**

Indeksi për Gjithëpërfshirje është instrument që ka gjetur shumë përdorim në të gjitha shkollat të cilat janë trajnuar për të. Indeksi iu mundëson shkollave të identifikojnë problemet që mund t'i kenë brenda shkollës dhe të parashohin veprimet adekuate për t'i zgjidhur ato probleme. Shembuj: në shkollën “Ibrahim Fehmiu” në Prizren, Indeksi iu ka ndihmuar që të përmirësojnë pastërtinë në shkollë. Në shkollën “Zekeria Rexha” në Gjakovë, Indeksi ka ndihmuar stafin e shkollës të përpilojë planin zhvillimor të shkollës. Në shkollën “Abaz Ajeti” në Gjilan, Indeksi ka ndihmuar të luftojë bullizmin në shkollë.

➤ **Trajnimet**

Trajnimet luajnë rol kyç në ngritjen e kapacitetve të mësimit brenda shkollës. Trajnimet iu mundësojnë atyre të përditësohen me metodologji të re të trajtimit sa më adekuat të fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre në mes vete.

Shumica e mësimit brenda shkollës të intervistuar në 7 shkollat e përzgjedhura për udhëzues kanë ndjekur trajnimin me 12 module, dhe kanë pohuar se ky program trajnimi ka qenë i domosdoshëm dhe efektiv në punën e tyre të përditshme. Të gjithë mësimit brenda shkollës janë të gatshëm për trajnime të tjera, të cilat do të rrisin njohuritë e tyre.

➤ **Mësimdhënësit/et mbështetës/e**

Shkolla “Asim Vokshi” në Prishtinë ka dy mësimit brenda shkollës mbështetëse. Ato janë shumë të lidhura me të gjithë rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë dhe së bashku me mësimit brenda shkollës e tyre janë shumë efektive në punën që bëjnë. Mësimit brenda shkollës konsiderojnë ndihmën e mësimit brenda shkollës mbështetëse si pjesën kryesore të fillimit dhe vazhdimin e punës me fëmijë, duke treguar që ato janë shumë të afta, profesionale dhe korrekte në punën e tyre. Vullneti dhe gatishmëria e përhershme e mësimit brenda shkollës mbështetës është çelësi kryesor për suksesin me nxënësit.

REFERENCAT

- Aftësia e kufizuar te fëmijët në Shqipëri: Prevalenca e aftësisë së kufizuar, aksesit te shërbimet dhe cilësia e shërbimeve, 2018.
- Arsimiti gjithëpërfshirës: e drejtë e secilit. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Departamenti për Politikën e Arsimit Parauniversitar - Divizioni i Arsimit me Nevoja të Veçanta. (Shkurt 2014).
- Doracak mbi gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Handikos dhe Save the Children, (Prishtinë 2016).
- Inclusive education: What, Why, and How, Save the children, 2016.
- Indeksi për gjithëpërfshirje – fakte dhe opinione: Dr. Naser Zabeli & Ma. Lulavere Behluli, Dhjetor 2014.
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Prishtinë. (Gusht, 2016).
- Mbështetja e qendrave burimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkollat të rregullta.
- Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë: Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Prishtinë. (Dhjetor, 2014).
- Organizimi i sistemit mbështetës në Institucione edukativo-arsimore: Botimi i broshurës u mbështet nga projekti 'Mbështetja për Reformën e Arsimit Gjithëpërfshirës 2015' i financuar nga Ambasada e Finlandës në Prishtinë zbatuar nga organizata KAPIE.
- Plan strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë 2016 – 2021. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Prishtinë. (2016).
- Plani individual i arsimit (PIA) dhe udhëzuesi për hartimin e planit individual të arsimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Prishtinë. (2017).
- Plani Strategjik 5 vjeçar për Arsimin Gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar (2016 – 2021). Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Prishtinë. (2016).
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2022 – 2026 (PSAK). Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Prishtinë. (2022).
- Praktika pozitive në arsimin gjithëpërfshirës. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Prishtinë. (2017).
- Vlerësimi i Realizimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017 – 2021: Arritje e Pamjaftueshme, KEC. (2021).
- Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/21, MASHT-ASK, (2021).
- UA 16/2017 Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.
- UA 18/2013 Përdorimi i planit individual të arsimit.
- UA 22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës.
- UA 23/2013 Qendrat burimore.
- UA 24/2013 Shndërrimi i klasave të bashkëngjitura në dhoma të burimeve.
- UA 26/2012 Kualifikimi për personelin që punon me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.



Save the Children

Str. Filip Shiroka 27,
10000 Prishtine, Kosovo
Phone. +383 38 551 691
Fax +383 38 551 693
Email scik@savethechildren.org
Web <http://kosovo.savethechildren.net>